REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETARI I K.K.T.-së
Z. EDI RAMA

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Z. DAMIAN GJIKNURI

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Z. Imer Hoxha

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak
Nr. 95 Datë 27.11.2017

Kryetari i Bashkisë
Z. Besnik Dushaj

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR I BASHKISË TROPOJË

RREGULLORE E PLANIT

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.2, Datë09.12.2017

DPKZHT: HASAN ÇUKA

STUDIO KONSULENTE "STUDIO B&L": ERMAL BLETA, Nr.Liç. A.0925/4

STUDIO B & L
Sh p k
Tiranë Albania

Kjo rregullore është përgatitur në kuadrin e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tropojë.

Përgatitur nga:
Studio B&L me Pier Vittorio Aureli dhe Martino Tattara

Doriana Bozgo Bleta, Ermal Bleta, Roland Lika - *Endri Kiçaj, Juela Guri, Saimir Duçellari*

Martino Tattara, Pier Vittorio Aureli - *Antonio Paolillo, Ezio Melchiorre, Ian Lowrie, Luciano Aletta, Matteo Novarino, Tommaso Mola Meregalli*

Andrian Vaso, Bukurosh Onuzi, Devis Agaraj, Genti Neschwatal, Ilia Kristo

Kontakt: studio@arkitekt-bl.com
info@dogma.name

Me mbështetjen e:

dldp decentralisation and local development programme

HELVETAS Swiss Intercooperation

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

PASQYRA E LËNDËS

1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1.1 NENI 1 - Objektivat dhe drejtimet e rregullores

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tropojë, ka për objektiv kryesor zhvillimin e balancuar dhe të integruar rajonal të Tropojës, nëpërmjet një shpërndarje të funksioneve të përdorimit të territorit kundrejt vizioneve strategjike për krijimin e një modeli të ri zhvillimi që mundëson harmonizimin e hapësirave me karakteristika të ndryshme gjeografike dhe social-ekonomike.

Nëpërmjet PPV-së në këtë rregullore synohet kushtëzimi ligjor i trajtimit të zonimit funksional të territorit kundrejt dy parimeve kryesore:

- Përcaktimin e përdorimit të lejuar të tokës, sipas përcaktimeve të parashikuara nga ky plan; dhe
- Identifikimin e kushteve bazë të mënyrës së ndërhyrjes në territor.

Në këtë rregullore do të përcaktohen rregullat, normat dhe standardet të cilat do të udhëheqin zhvillimin dhe transformimin e territorit në drejtim të objektivave të synuara nga Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tropojë.

1.2 NENI 2 - Afatet dhe vlefshmëria e planit

1. Plani i Përgjithshëm Vendor është hartuar në respektim të kushteve ligjore të përcaktuara nga Ligji i Planifikimit të Territorit Nr. 107/2014 dhe Rregulloreve të Planifikimit dhe Zhvillimit në funksion të tij.
2. Ky plan është i vlefshëm për një periudhë kohore prej 15 vitesh.
3. Pas kësaj date, plani do ti nënshtrohet rishikimit në përputhje me legjislacionin kombëtar që do të jetë në fuqi në kohën e rishikimit.

1.3 NENI 3 - Zgjidhja e konflikteve dhe mospërputhjeve

1. Në rast të mospërputhjeve midis elementëve të këtij plani, dispozitat në tekst dhe formatet tabelare kanë prioritet mbi elementët grafike.
2. Në rast të mospërputhjeve të normave, parametrave dhe rregulloreve të këtij dokumenti, dispozitat kufizuese sundojnë mbi ato më pak kufizuese.
3. Në rastet kur një pronë apo grup pronash, të përfshira nga PPV në përdorimin (N) - sistemi natyror, gëzojnë statusin e tokës bujqësore, përpara aprovimit të këtij plani e kësaj rregulloreje, merret i mirëqenë statusi ekzistues i përcaktuar nga dokumenti .
4. Në rastin e mospërputhjeve midis rregullave të këtij dokumenti dhe legjislacionit

tjetër kombëtar, rregulloret kombëtare kanë prioritet kundrejt parashikimeve të këtij dokumenti.

1.4 NENI 4 - Ndryshime apo rishikime të dokumentit të planit

Plani është objekt ndryshimi apo rishikimi sipas përcaktimeve ligjore të Nenit 26 të ligjit të planifikimit të territorit, dhe në çdo rast objekt rishqyrtimi të plotë çdo 15 vjet.

1. Rastet për të cilat kërkohet rishikimi i nënshtrohen procedurës të thjeshtuar sipas përcaktimeve të ligjit dhe akteve nënligjore në funksion të tij në fuqi.

2. Përcaktimet për infrastrukturën e shërbimeve apo të përkufizimeve të tjera në nivel planifikimi, subjekt të standarddeve të rregulloreve kombëtare të planifikimit, janë subjekt rishikimi apo rishqyrtimi nëse standardet në fuqi në kohën e miratimit të këtij plani ndryshohen si pasojë e rishikimit apo nevojës të përshtatjes të tyre me kriteret dhe rregulloret e planifikimit sipas standardeve të kërkuara nga Bashkimi Europian.

1.5 NENI 5 - Përkufizimet

1. Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

   a. *"Njësi strukturore"* - është sipërfaqja më e vogël e territorit e përkufizuar nga Plani i Përgjitshëm Vendor, e identifikuar dhe planifikuar me kushte të njëtrajtshme zhvillimi sipas përcaktimeve të kësaj rregullore.

   b. *"Sistem territorial"* - është tërësia e përdorimeve, strukturave, punimeve të lejuara, aktiviteteve, funksioneve dhe elementeve natyrore dhe artificiale territoriale, të cilat kanë lidhje me njëri-tjetrin për nga karakteri dhe qëllimi i planifikimit dhe i zhvillimit të cilin synojnë të realizojnë.

   c. *"Sipërfaqe bruto e njësisë strukturore"*- është sipërfaqja brenda aksit të rrugëve që kufizojnë njësinë strukturore. Në rast se njësia strukturore nuk kufizohet nga rrugë, është sipërfaqja e territorit brenda vijës së kufirit të pronave që përfshihen në njësinë strukturore përfshirë prona private dhe publike.

   d. *"Sipërfaqe neto e njësisë strukturore"*- është sipërfaqja e parcelave të përfshira në të drejta zhvillimi në njësinë strukturore.

   e. *"Zonimi"* - është ndarja e një territori në njësi strukturore për qëllime planifikimi dhe kontrolli të zhvillimit të territorit.

   f. *"Zonim i përdorimit të tokës"* - është përcaktimi i kategorive të lejuara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të për secilën njësi strukturore, për qëllime planifikimi dhe kontrolli të zhvillimit të territorit.

   g. *"Tipologji hapësinore e përdorimit të tokës"* - është karakteri i një njësie

strukturore bazuar në ndërthurjen e njëtrajtshmërisë së llojit dhe volumit të strukturave, mënyrës së vendosjes së tyre në territor, skemës rrugore dhe të hapësirave publike.

h. *"Përdorim homogjen"* - është përdorimi që karakterizohet nga ekzistenca e strukturave që i shërbejnë të njëjtit funksion mes njëra-tjetrës, ndonëse dhe miks në vetvete, në të gjithë sipërfaqen e tokës ku evidentohet përdorimi, dhe nga aktivitete të përputhshme që i shërbejnë të njëjtit funksion.

i. *"KSHT, koeficienti i shfrytëzimit të tokës"* - për ndërtim është raporti ndërmjet sipërfaqes së gjurmës së strukturës të vendosur në parcelë/grup-parcelash me sipërfaqen e përgjithshme të parcelës/grup-parcelave

j. *"Intensiteti"* – është raporti ndërmjet sipërfaqes të përgjithshme të ndërtimit mbi tokë / sipërfaqen e tokës në dispozicion për ndërtim.

k. *"Intensiteti bruto"* – është raporti ndërmjet sipërfaqes të përgjithshme të ndërtimit mbi territorin e njësisë strukturore / sipërfaqen e përgjithshme të njësisë strukturore.

l. *"Intensiteti neto"* – është raporti ndërmjet sipërfaqes të përgjithshme të ndërtimit mbi parcelë ose grup-parcelash / sipërfaqen e përgjithshme të parcelës ose grup-parcelave.

m. *"Kategoritë e lejuara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të"* - për çdo njësi strukturore, kjo rregullore përcakton kategorite e zhvillimeve të lejuara në përputhje me Planin e Përgjithshëm;

n. *"Kategoritë e kushtëzuara të përdorimit të tokës dhe të strukturave në të"* – janë ato kategori ndërhyrje në territor të cilat kushtëzohen përmes detyrimeve shtesë në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje dhe të Planit të Përgjithshëm Vendor;

o. *"Parcelë"* – është termi i përdorur në këtë rregullore zhvillimi që nënkupton të gjitha përkufizimet ligjore dhe teknike të konceptit pronë, e identifikuar me numër të parcelës dhe e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

p. *"Hapësira të hapura"* - janë hapësira të pandërtuara ndërmjet strukturave, publike apo private, sipas rastit rrugë për hyrje në strukturë ose hapësira me një mbulesë vegjetacioni, sheshe parkimi, vendqëndrime dhe hapësira të gjelbra në funksion të strukturës së ndërtuar sipas parashikimeve të lejes të ndërtimit apo studimit dhe pjesë e parcelës së ndërtueshme.

q. *"Zhvillim i qëndrueshëm"* - është zhvillimi social, ekonomik, territorial dhe mjedisor që u përgjigjet nevojave të brezave të sotëm dhe që nuk rrezikon, demton apo pakëson burimet për brezat e ardhshëm.

r. *"Vijë ndërtimi"*- është kufiri maksimal i lejuar për vendosjen e një strukture në lidhje me trupin e rrugës ose kufirin e njësisë që i referohet.

s. *"Gjelbërim filtrues"* – është pjesa e sipërfaqes së gjelbër për realizimin e filtrimit të ujërave në tokë, e lirë nga çdo lloj ndërtimi mbi apo nëntokë, e përllogaritur si koeficient shfrytëzimi i territorit për hapësira publike.

t. "Park" – është hapësira natyrore e kufizuar, me gjelbërim të lartë dhe të mesëm, pjesë e territorit urban dhe sub-urban, me qëllimin e përmirësimit të cilësisë së kushteve mjedisore dhe social kulturore të banorëve të territorit.

u. *"Plan i Detajuar Vendor"* - instrumenti që përcakton kushtet e zhvillimit përmes analizës së detajuar të territorit dhe zbërthimit të rregullave të përcaktuara nga plani i përgjithshëm vendor për një apo më shumë njësi strukturore.

v. *"Rrjet i KUZ"* - nënkupton sistemin e kanalizimit të ujrave të zeza të përbërë nga një rrjet i vogël i centralizuar i ujrave të zeza dhe rrjet shkarkimi i pavarur.

w. *"Kooperativa bujqësore"* - janë ato kooperativa ku fermerët (së paku 3) bashkojnë burimet dhe produktet e tyre në fusha të caktuara të veprimtarisë.

x. *"Zonat ekonomike"* – janë ato zona, pjesë të një apo më shumë njësish strukturore, të cilat si pasojë e morfologjisë territoriale, rrjetit të infrastrukturës apo tipit të aktivitetit ekonomik që zhvillohet në të, përcaktohen si sipërfaqe homogjene të karakterit ekonomik.

** Termat e tjerë të përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ata të përcaktuar në ligjin 107/2014 apo në aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.*

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT
TIRANE
SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT
TIRANE

2 PËRKUFIZIMI I TERRITORIT DHE SISTEMET

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

2.1 NENI 6 - Pesë sistemet dhe elementët e territorit

1. Njësitë e qeverisjes vendore për qëllime planifikimi ndahen në sisteme territoriale që klasifikohen si vijon:

a. *Sistemi urban (UB):* formësohet nga kufiri i ndërthurjes të territorit urban me territorin natyror, ujor apo bujqësor. Elementët e këtij sistemi përmbledhin të gjitha strukturat e ndërtuara aktualisht nga lashtësia deri në kohët moderne, nga ndërtesat publike në ato industriale, si dhe ato territore të planifikuara për zhvillim urban. Kjo tipologji elementësh ofron një panoramë varieteti tipologjish strukturash.

b. *Sistemi natyror (N):* përbëhet nga sipërfaqe të paprekura natyrore, parqe kombëtare, rezervatet në mbrojtje, eko-sistemi i arrorëve, gështenjave, sipërfaqet akullnajore të përhershme, etj.

c. *Sistemi bujqësor (B):* përbëhet nga sipërfaqe toke bujqësore, të zëna me të mbjella gruri, misri, vreshtash, dru-frutorësh, të kudo-ndodhura, si dhe infrastrukturën inxhinierike dhe teknike në shërbim të aktiviteteve të lidhura me këtë sistem.

d. *Sistemi ujor (U):* përfshin të gjithë sistemin e ujrave dhe burimeve nëntokësore dhe mbitokësore, të gjithë trupat ujor përfshirë ato të përkufizuar në legjislacionet specifike.

e. *Sistemi infrastrukturor (IN):* përfshin të gjitha rrjetet e infrastrukturës në nivel vendor, rajonal dhe kombëtar. Ky sistem formësohet nga rrjetet e infrastrukturës inxhinierike si dhe nga kategoritë bazë të përdorimit të tokës.

2.2 NENI 7 - Hierarkia Territoriale

1. Përtej përcaktimit të 5 sistemeve, territori urban i Bashkisë Tropojë është klasifikuar në dy makro klasifikime për qëllim planifikimi dhe administrimi, në një hierarkie sipas zhvillimit aktual dhe të propozuar në territor, si vijon:

1. *territor urban*
2. *territor rural*

- Plani përcakton si "territor urban" sipërfaqen e territorit të ndërtuar apo në proçes zhvillimi dhe rizhvillimi, të përbërë nga territor urban kompakt, me densitet të lartë dhe mesatar, ku mbizotërojnë funksionet urbane të banimit, të shërbimit publik, kulturore, ekonomike dhe tregtare.

- Plani përcakton si "territor rural" të gjithë territorin, të vendosur kryesisht përtej kufijve të territorit urban, ku bëjnë pjesë edhe grumbullimet e vogla tradicionale urbane si fshatrat, ndërtesat e shpërndara të ndërthurura me territoret bujqësore dhe natyrore, ku ekonomia bazohet kryesisht në bujqësi dhe blegtori.
- Përkufizimi dhe klasifikimi i territorit sipas parashikimeve të këtij neni është reflektuar në hartën përkatëse të hierarkisë territoriale. Parcelat apo strukturat e prekura nga kufiri i secilit nivel klasifikimi, do të jenë pjesë e territorit me hierarki më të lartë planifikimi vetëm nëse 60% ose më shumë e sipërfaqes të parcelës apo sipërfaqes totale të strukturës së tyre, ndodhet brenda territorit me hierarki më të lartë klasifikimi.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

3 PËRCAKTIMI I TERRITORIT PËR PLANIFIKIMIN DHE ADMINISTRIMIN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

3.1 NENI 8 - Kriteret e përcaktimit të zonës

1. Bazuar në përkufizim, zona është një pjesë e territorit, me karakteristika ose përdorime të veçanta apo të njëjta, ekzistuese a të planifikuara në të.
2. Kriteret për përcaktimin e zonave në këtë plan të përgjithshëm vendor kanë qënë kryesisht nën-ndarja e sistemit urban që janë krijuar nga procesi i zonimit.
3. Zonat përbëhen nga një apo më shumë njësi strukturore dhe përcaktojnë kushte të përgjithshme administrimi dhe inventarizimi të parametrave të planifikimit të përllogaritura sipas përcaktimeve ligjore në nivel zonë.
4. Kufijtë e zonave, janë përcaktuar sipas përkufizimit të një apo disa njësive strukturore që përfshin në territorin e një zonë, duke e sintetizuar ndarjen territoriale për qëllime planifikimi nga qëliza më e vogël territoriale, njësia strukturore, në nocionin përgjithësues të planifikimit dhe administrimit, zonës.

3.2 NENI 9 - Kriteret e përcaktimit të njësive strukturore

1. Ndarja në njësi strukturore bëhet për qëllime të planifikimit, e të zbatimit të Planit të Përgjithshëm, të realizimit dhe kontrollit të zhvillimit dhe përbën qelizën më të vogël të planifikimit dhe qelizën më të madhe të zhvillimit në një territor. Çdo kërkesë për zhvillim bazohet në treguesit e planifikimit dhe kushtet e zhvillimit që vendosen në Planin e Përgjithahëm Vendor për njësinë strukturore përkatëse.
2. Njësitë strukturore krijohen në përputhje me përcaktimet e pikës 3 të këtij neni dhe nga mbivendosja e hartës së kategorive të përdorimeve të tokës dhe të strukturave në të, sipas rastit të propozuara ose ekzistuese, me hartat e tjera të planit të propozuar të përdorimit të tokës dhe planit të infrastrukturave dhe shërbimeve sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
3. Kufijtë e njësive strukturore, janë përcaktuar duke ju referuar këtyre kritereve të detyrueshme, por pa u kufizuar vetëm në to:
   a. Kufizimi nga rrjeti rrugor kryesor ekzistues dhe/ose i propozuar, dhe sipas rastit edhe nga kufizues të tjerë natyralë e artificialë, të cilët krijojnë elementë me karakter qartësisht të matshëm në territor, dhe sipas rastit mund të përfshijnë vija ujore, lumenj ose përrenj, kanale të hapura dhe të tjera të kësaj natyre;
   b. Ekzistenca e një ekuilibri midis përdorimeve dhe funksioneve brenda çdo njësie strukturore, që përcaktohet përmes treguesve të planifikimit dhe të zhvillimit të cilët garantohen në çdo njësi;

c. Ekzistenca e funksioneve urbane që plotësojnë njëri-tjetrin dhe nevojat e popullatës urbane;

d. Bashkë-ekzistenca e përdorimeve të tokës dhe të strukturave në një njësi strukturore që janë të përputhshme dhe nuk paraqesin raste të përdorimeve të ndaluara, ose sipas rastit ekzistenca e përdorimit homogjen të tokës dhe strukturave në të, për të gjithë njësinë;

e. Rëndësia që ka njësia strukturore në historinë territoriale qytet-formuese të territorit përkatës;

f. Ekzistenca e identiteteve dhe karakteristikave të veçanta që njësia strukturore mund të ketë, duke përfshire vlerat e trashëgimisë kulturore dhe vlera të rëndësishme mjedisore.

4. Në çdo rast, kriteret e detyrueshme për përcaktimin e një njësie strukturore, por pa u kufizuar vetëm në to, përfshijnë:

a. Garantimin e kompaktësisë dhe njëtrajtshmërisë se tipologjisë hapësinore ekzistuese dhe/ose të propozuar;

b. Ekzistencën e treguesve të njëtrajtshem të planifikimit dhe të zhvillimit;

c. Ekzistencën e përdorimit homogjen të tokës dhe të strukturave në të, sipas kategorive bazë të përdorimit dhe nënkategorive të përdorimit të parashikura nga Plani i Përgjithshëm Vendor, përfshirë edhe funksione ose aktivitete homogjene. Në rastet kur për arsye të përligjura, njësia ka ose parashikohet të ketë përdorim të përzier, atëhere treguesit e zhvillimit dhe të planifikimit paraqiten për çdo kategori ose nënkategori përdorimi;

d. Ekzistencën e vlerave të rëndësishme të trashëgimisë kulturore dhe aspekte të rëndësishme të mjedisit dhe shëndetit, sipas rastit;

e. Kufizimin nga rrjeti rrugor, pavarësisht nga kategoritë e rrugëve, dhe nëse është rasti nga linja hekurudhore, kanale të hapura, breza sanitarë, vija ujore, përrenj, lumenj, dhe të tjera të kësaj natyre;

f. Paracaktimin e një zonë me prioritet zhvillimi ose për realizimin e një projekti me rëndësi në nivel qyteti nga Plani i Përgjithshëm Vendor.

5. Në të gjitha rastet, kufijtë e njësive strukturore do të saktësohen gjatë hartimit të PDV-së, e cila do të identifikojë qartë grafikisht kufirin e njësisë strukturore sipas mënyrës së menaxhimit të parcelave apo saktësimit të tyre në shkallën përkatëse.

6. Në rastet kur parcela që shtrihen në 2 apo më shumë njësi strukturore do të zhvillohen apo trajtohen sipas kushteve të zhvillimit të njërës prej njësive kufitare, atëhere

kufiri i njësisë strukturore do të konsiderohet i ndryshuar, duke përjashtuar parcelën e trajtuar në njësinë fqinjë.

3.3 NENI 10 - Kategoritë bazë të përdorimit të tokës

1. Kategoritë bazë të përdorimit të tokës dhe të strukturave në të, shërbejnë si referencë në proçesin e zonimit sipas përdorimit të tokës, të kryer nga autoriteti i planifikimit. Përcaktimi i tyre bëhet në zbatim të definicioneve të Nenit 80 të VKM Nr. 686, date 22.11.2017.

2. Autoriteti i planifikimit, i referohet dhe përdor gjatë procesit të zonimit sipas përdorimit të tokës dhe strukturave në të, këto kategori dhe kode:

1. Përdorimi Banim, me kod "A";
2. Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të banimit dhe strukturave ndihmëse në funksion të tij si: funksione të lehta apo në shkallë të vogël tregtimi, ndërtim banimi sezonal, funksione turistike të lehta, zyra, banka, dhe funksione publike.

3. Përdorimi Ekonomi dhe Industri , me kod "IE";
4. Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të industrisë dhe ekonomisë dhe strukturave ndihmëse në funksion të tyre si: industri e rëndë, nxjerrje dhe përpunim materialesh ndërtimi, nxjerrje dhe përpunim mineralesh, park logjistik, industri përpunuese, ushqimore, magazinime, etj.

5. Përdorimi Bujqësi, me kod "B";

6. Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të bujqësisë dhe strukturave ndihmëse në funksion të saj si: toka bujqësore, fusha bujqësore, tarraca të mbjella me ullishte, vreshta, dru-frutorë, prodhimet e serave, struktura për prodhimin e vajrave, të shitjes, të magazinimit, agro-turizëm, etj.

7. Përdorimi Shërbime, me kod "S";

8. Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të shërbimeve dhe strukturave ndihmëse në funksion të tyre si: restorante, bare, dyqane, shërbime tregtare, supermarkëtë, ipermarkëtë, tregtim me pakicë, me shumicë, ushqimore, aktivitete të vogla prodhuese, hoteleri, panaire, zonat e parkimit, qëndra biznesi, zyra, etj.

9. Përdorimi i Veçantë, me kod "V";

10. Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të varrezave.

11. Përdorimi Ujëra, me kod "U";

12. Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të ujrave mbitokësore, si aktivitete të lehta rekreative, peshkim, struktura të lehta për lundrim apo parkim, pellgje ujitës, shtigje rekreative për këmbësorë apo me biçikleta, linja ujore, lumenj, përrenj, liqene, përfshirë brigjet, etj., sipas legjislacionit për ujërat.

13. Përdorimi Toka Natyrore, me kod "N";

14. Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të natyrës, si pyje, male, kodra, fusha, kullota, tokat e pafrytshme, e gjithçka tjetër përfshin mjedisi natyror sipas përcaktimeve të ligjeve për mjedisin, biodiversitetin, zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës.

15. Përdorimi Trashëgimi dhe Monumente kulture dhe historike, me kod "M";

16. Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të trashëgimisë dhe monumenteve të kulturës dhe historike, parqe arkeologjike si dhe zona monumentale.

17. Përdorimi Zona Ushtarake, me kod "ZU";

18. Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të zonës ushtarake.

19. Përdorimi Institucione, me kod "IS";

20. Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të institucioneve, administrata publike shtetërore pavarësisht nivelit, sistemit gjyqësor, bankat, mediat, institucione të mbrojtjes civile dhe kombëtare përjashtuar ato që përfshihen në kategoritë e tjera, të shërbimeve të ndihmës dhe kujdesit social, të shoqërisë civile, sistemi i burgjeve dhe institucioneve fetare, etj.

21. Përdorimi Aktivitete Shoqerore & Argetimi, me kod "SHA";

22. Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të aktiviteteve sociale dhe rekreacionit si: qëndër kulturore, terrene sportive, salla koncertesh, kinema, teatër, muze, opera, hapësira publike, argëtuese, parqe, hapësira rekreative, funksione publike, gjelbërim, shërbime për

interes vendor, etj.

23. Përdorimi Arsim, me kod "AS";

24. Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të arsimit publik.

25. Përdorimi Shëndetësi, me kod "SH";

26. Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të strukturave të shëndetit publik.

27. Përdorimi Infrastruktura, me kod "IN".

28. Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të infrastrukturës si stacione, terminale, impjanti i trajtimit të ujrave të zeza, fabrika riciklimi, kompostimi, landfille, porte, rrugë kryesore nacionale, nyje transporti, hekurudha, ujësjellës, mbetjet e ngurta dhe të lëngshme, furnizimi me ujë, naftë, gaz, biokarburantet, furnizimi me energji elektrike, komunikimi elektronik, elementët mbrojtës të tokës nga erozioni, rrëshqitjet e tokës, mbrojtja nga zjarri, etj., sipas legjislacioneve të posaçëm.

3.4 NENI 11 - Kategoritë e parashikuara të përdorimit të tokës për njësitë strukturore me përdorim të përzier (Mikse)

1. Në mënyrë që të theksohet dinamika urbane dhe të krijohen mundësi të mëdha për kombinimin e aktiviteteve në qytet, do të përcaktohen njësitë strukturore me përdorim të përzier (mikse).

2. Kombinimi i këtyre aktiviteteve duhet të jetë në përputhje me treguesit e ndikimit në mjedis (ndotja e ajrit dhe akustike, gjenerimi i trafikut, prania e infrastrukturës dhe administrimi i rrezikut).

3. Për njësitë strukturore të cilat nuk kanë vetëm një nga kategoritë e përdorimit të përcaktuara në Nenin 10 të kësaj rregulloreje, si edhe për të gjitha njësitë strukturore me përdorime të përziera, do të përcaktohen :

   a. Përdorimet e lejuara, të ndalura apo të kushtëzuara për njësinë;
   b. Përqindja (%) përkatëse e çdo përdorimi apo sipërfaqja përkatëse e përcaktuar për secilin përdorim.
   c. Mënyrat e ndërhyrjes dhe kushtet e zhvillimit për secilin përdorim sipas raportit përkatës në njësi.
   d. Në të gjitha njësitë strukturore me kategori të përziera të përdorimit të tokës,

raportet e përdorimeve për çdo njësi mikse jepen në pasaportat përkatëse.

e. Në të gjitha pasaportat e njësive strukturore me kategori të përziera të përdorimit të tokës ku nuk janë shprehur raportet e secilit përdorim, lejohet përdorimi i secilës prej kategorive të përcaktuara si të lejuara në pasaportë, pa kufizime, me kushtin e respektimit të përdorimeve të përcaktuara për njësinë përkatëse.

4. Për njësitë strukturore të përziera me kategorinë e përdorimit A-banim, transformimet e banesave në objekte tregtare ose zyra, janë të lejuara vetëm përgjatë rrugëve kryesore që kufizojnë njësinë.

5. Ndërthurja e përdorimeve përfshin kategoritë e përcaktuara në legjendën e mëposhtme:

a. **(IE, A) - Banim dhe industri e ekonomi** - Kjo kategori e përdorimit të tokës shkrin në një njësi ndërtimore banimin dhe punën si funksione të kombinuar. Për shembull, inkubatorët e biznesit dhe parqet logjistik, magazinat tregtuese, zyrat, strukturat ndihmese perkatëse, etj, mund të plotësohen me funksione banimi për ata që punojnë atje;

b. **(S+A) – Shërbime dhe banim (tregtare)** - Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përzierjen e shërbimeve të karakterit tregtar si zyra, dyqane, bare, zyra, restorante, supermarkëtë, ipermarkëtë, aktivitete të vogla prodhuese, tregtim me shumice dhe pakice, etj, dhe përdorimit banim brenda të njëjtës njësi ndërtimore. Synimi kryesor i kësaj kategorie të përdorimit të tokës është të mbështesë fleksibilitetin e të jetuarit dhe punuarit brenda të njëjtës strukture urbane;

c. **(A, S) – Banim, shërbime** - Kjo kategori e përdorimit të tokës përqëndrohet në përfshirjen e një raporti të reduktuar të banimit në njësi më përdorim shërbim.

d. **(IE, S) – Industri, ekonomi dhe shërbime (tregtare)** - Kjo kategori e përdorimit të tokës bazohet në përzierjen e funksioneve tregtare, dyqane, bare, zyra, restorante, supermarkëtë, ipermarkëtë, aktivitete të vogla prodhuese, panaire, tregtim me shumice dhe pakice, etj, brenda të njëjtës njësi ndërtimore. Qëllimi kryesor i kësaj tipologjie është të mbështesë fleksibilitetin e veprimtarive prodhuese brenda të njëjtave hapësira;

e. **(A,B) - banim dhe bujqësi** - Kjo kategori e përdorimit bazohet në përfshirjen e një raporti të bujqësisë në njësi të përdorimit banim.

f. **(SHA+S) - Aktivitete Shoqerore & Argetimi dhe shërbime** - Kjo përzierje e përdorimeve të tokës fokusohet në përdorimet tregtare dhe shërbimet e hotelerisë, restorante dhe strehimet agro-turistike, në shkallë të vogël, hapësira sportive, hapësira rekreative, shërbime publike, zona parkimi, funksione publike, aktivitete

sociale, etj;

g. **(SHA+S+A) – Aktivitete Shoqerore & Argetimi, shërbime dhe banim** - Kjo kategori e përdorimit të tokës përqëndrohet në përzierjen e përdorimeve të aktiviteteve rekreative, zona sportive, shërbimeve si restorante, bare, etj dhe banimi;

h. **(B+N) – Bujqësi dhe natyrë** - Kjo kategori e përdorimit të tokës përqëndrohet në përzierjen e karakterit bujqësor me atë natyror në territor.

3.5 NENI 12 - Kategoritë e lejuara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të

1. Kategoritë e lejuara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të për një zonë të caktuar, nënkuptojnë kategoritë e zhvillimeve të lejuara në atë zonë sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje për kategoritë bazë dhe në perputhje me instrumentet e planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit në fuqi.

2. Për çdo njësi strukturore, për të cilat janë përcaktuar *"përdorime të tjera të lejuara"*, këto lloj përdorimesh realizohen vetëm për disa nën-kategori sipas rastit dhe deri në atë masë që mund të akomodojë kapaciteti mbajtës i zonës. Ky përkufizim nuk përfshin kategoritë e ndaluara.

3. Kategoritë e lejuara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të:

a. ndajnë përkatësisht përfitimet e ndërsjella,

b. nuk bien në kundërshtim me qëllimin e zonimit, me funksionet dhe me natyrën e kategorive bazë të përdorimit të tokës dhe të strukturave në të në një zonë,

c. përputhen me kushtet e vendosura nga dispozitat ligjore në fuqi dhe nga instrumentet e planifikimit në fuqi, për sigurinë e mjedisit, të shëndetit, të tokës bujqësore dhe të vlerave historike dhe kulturore për përdorimet dhe funksionet ekzistuese dhe të autorizuara apo propozuara në njësinë përkatëse dhe ato fqinjë apo kufitare.

3.6 NENI 13 - Kategoritë e kushtëzuara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të

1. Kategoritë e kushtëzuara të përdorimit të tokës dhe të strukturave në të për një njësi të caktuar, vlerësohen zhvillimet jo të ndaluara, realizimi i të cilave lejohet përmes plotësimit të kushteve shtesë ose të reja në kërkesën përkatëse për zhvillim dhe në përputhje me përcaktimet e kësaj rregullore zhvillimi dhe të rregulloreve të planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit në fuqi.

2. Në çdo rast, edhe nëse autoriteti i planifikimit nuk e ka përcaktuar paraprakisht nëse një zhvillim është i lejuar, i ndaluar ose i kushtëzuar, ose nuk ka parashikuar kushte shtesë për zhvillimin e kushtëzuar, ai mund t`i kërkojë zhvilluesit të përgatitë një studim/plan të ndikimit nga zhvillimi para se të vendosë për lejimin ose jo të zhvillimit.

3. Përdorime të kushtëzuara janë ato që përcaktohen për çdo njësi strukturore/ zonë me prioritet zhvillimi në këtë rregullore. Përjashtim bëjnë ato raste të cilat përcaktohen ndryshe në këtë rregullore:

   a. Përdorimet e kushtëzuara përmbushin përcaktimet e rregullores së planifikimit të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.

   b. Pikat e furnizimit të karburantit lejohen në zonë urbane vetëm pasi plotësojnë kushtet e distancave prej të paktën 60 m nga ndërtimet e tjera të çdo lloji, të pajisen me lejen mjedisore përkatëse dhe miratimin nga institucioni përgjegjës për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

   c. Djegia e mbeturinave organike të aktivitetit bujqësor në tokë bujqësore është aktivitet i kushtëzuar. Lejohet vetëm pas vlerësimit të rrezikut të ndotjes nga bashkia dhe kur pika e djegies është të paktën 300 metra nga ndërtimi më i afërt, pavarësisht funksionit të tij.

   d. Industria e përpunimit dhe paketimit të produkteve ushqimore është aktivitet i kushtëzuar në zonë banimi dhe/ose në zonat fqinjë me ato të banimit, si dhe lejohet vetëm pasi plotëson kushtet e distancave nga ndërtimet e tjera, pajiset me lejen mjedisore përkatëse dhe kur institucioni përgjegjës miraton Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Kjo industri është e kushtëzuar edhe në territoret e sistemeve urbane dhe natyrore, apo në brigjet ujore dhe lejohet vetëm pasi plotëson kërkesat ligjore sektoriale të ujërave, mjedisit, tokës bujqësore, pyjeve dhe kullotave, zonave të mbrojtura natyrore dhe biodiversitetit.

   e. Përdorimet e kushtëzuara në territoret e zonave të mbrojtura natyrore dhe në zonat e tyre buferike, si dhe në zonat që mbrohen nga legjislacioni për trashëgiminë kulturore, përfshirë brezat mbrojtës/zonat buferike të këtyre zonave/objekteve, përcaktohen rast pas rasti në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi. Kushtet përcaktohen në legjislacionin në fuqi.

3.7 NENI 14 - Kategoritë e ndaluara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të

1. Me kategori të ndaluara të përdorimit të tokës dhe të strukturave në të për një njësi të caktuar, nënkuptohen zhvillimet e ndaluara në atë njësi, sipas përcaktimeve të kësaj

rregullore për kategoritë bazë dhe në përputhje me instrumentet e përgjithshme të planifikimit ne fuqi.

2. Kriteret për përcaktimin e zhvillimeve të ndaluara në një zonë, por pa u kufizuar vetëm në to, janë:

   a. Kategoritë e përdorimit të tokës që bien në kundërshtim me qëllimet e zonimit sipas përcaktimeve të kësaj rregullore zhvillimi dhe instrumenteve të planifikimit në fuqi;

   b. Kur një zhvillim kërkohet të realizohet në një zonë që i përket një kategorie bazë të ndryshme nga ajo e zhvillimit të kërkuar, për sa kohë që nuk parashikohet ndryshe dhe në mënyrë të argumentuar në instrumentin e planifikimit në fuqi;

   c. Çdo përdorim që pavarësisht nga kategoria bazë të cilës i përket, krijon ndotje në mjedis përtej parametrave dhe standarddeve të parashikuara në legjislacionin e posaçëm mjedisor, dëmton shëndetin, dëmton strukturat dhe monumentet e trashëgimisë kulturore;

   d. Çdo zhvillim në tokë bujqësore që edhe pse mund të jetë brenda kategorisë bazë të përdorimit të tokës dhe strukturave në të, nuk respekton rregullat, standarddet dhe treguesit e planifikimit dhe të zhvillimit sipas përcaktimeve të kësaj rregullore zhvillimi dhe të instrumentëve të planifikimit në fuqi;

3. Përdorime të ndaluara janë ato që përcaktohen për çdo njësi strukturore/zonë me prioritet zhvillimi në këtë Rregullore. Si rregull i përgjithshëm, përveç sa përcaktohet ndryshe në këtë rregullore:

   a. Përdorimet e ndaluara përmbushin përcaktimet e rregullores së planifikimit të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.

   b. Përdorime të ndaluara për njësitë e banimit janë: industritë e rënda, kimike dhe të tjera ndotëse me ndikim të lartë në mjedis; ndërtimet ushtarake; varrezat; impjantet e trajtimit të ujërave të ndotura; landfill-et; inceneratorët; parcelat komunitare të kompostimit të mbetjeve organike;

   c. Aktivitetet e zonës rurale, pavarësisht shkallës, si rritja e bletëve, mbajtja e bagëtive dhe gjedhëve, etj., të ngjashme janë të ndaluara në zonën urbane. Lejohen vetëm aktivitete të kultivimit dhe ortikulturës në oborret dhe kopshtet individuale të ndërtesave, në kuadër të bujqësisë urbane.

   d. Nuk lejohen aktivitete si djegia e mbeturinave të çfarëdo lloji në zonat e sistemit urban, të sistemit natyror apo në brigjet e burimeve ujore.

e. Përdorimet industriale janë të ndaluara të vendosen në brigjet ujore, në zonën buferike të zonave të mbrojtura natyrore pavarësisht kategorive, në zonat që mbrohen nga legjislacioni për monumentet e kulturës, përfshirë zonat buferike apo brezat mbrojtës të këtyre zonave/objekteve.

f. Të gjitha funksionet janë të ndaluara në hapësirën e përcaktuar si brez mbrojtës/ përkatësie, apo tampon/buferik për infrastrukturën rrugore dhe kanalet e kullimit dhe vaditjes të tokave bujqësore nga legjislacioni në fuqi.

3.8 NENI 15 - Ndryshimet në përdorimin e parashikuar të tokës për njësitë strukturore

1. Lejohen ndryshime të kategorisë të parashikuar të përdorimit të tokës në rastin e zhvillimeve komplekse të cilat janë të përputhshme me kategoritë ekzistuese të përdorimit ekzistues të tokës në njësinë përkatëse.

2. Në rastet kur bashkë-ekzistenca mes përdorimeve të lejuara të tokës dhe të propozuara për ndryshim sipas parashikimeve të këtij neni, janë të përputhshme, atëhere ndryshimi në përdorimin e parashikuar të tokës do të lejohet vetëm nga KKT sipas përcaktimeve ligjore për ndryshime në planin e përgjithshëm vendor dhe rregulloret e zhvillimit në funksion të tij.

3. Çdo rast ndryshimi sipas përcaktimeve të këtij neni, do të dokumentohet nga autoritetet vendore dhe do të publikohet në regjistrin kombëtar të planifikimit të territorit, dhe do të reflektohet në dokumentin e planit, hartat treguese si dhe rregulloren e zhvillimit, në rastin e parë të ndryshimeve apo përditësimeve të planit sipas përcaktimeve të Nenit 4 të kësaj rregullore dhe legjislacionit në fuqi.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT
TIRANE
SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA KOMBETARE E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT
TIRANE
SEKRETARIA

4 NDARJA E TERRITORIT PËR QËLLIME PLANIFIKIMI DHE KONTROLLI TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

4.1 NENI 16 - Zonimi

1. Zonimi i territorit bëhet për qëllime të planifikimit, për të lehtësuar përcaktimin e kategorive të tokës në bazë zonë dhe njësie dhe ka për qëllim:

   a. *Harmonizimin e përdorimeve të propozuara të tokës*

   b. *Ruajtjen dhe përmirësimin e vlerave apo karakterit të një zonë në përputhje me harmonizimin e interesave publike dhe private*

   c. *Zhvillimin e qëndrueshëm të territorit*

2. Zonimi detajon strategjinë e zhvillimit të territorit, e cila përcakton përmbajtjen thelbësore të PPV-së, që konsiston në:

   a. *Zonimin e përdorimeve urbane sipas shkallës dhe tipologjive*

   b. *Përcaktimin e zonave ekonomike dhe të shërbimeve*

   c. *Programin e veprimeve për implementimin e planit*

4.2 NENI 17 - Njësitë strukturore

Njësia strukturore është qeliza më e vogël e territorit për qëllime planifikimi e përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe përcaktimet e këtij plani.

1. Njësitë strukturore përmbajnë kushtet bazë të ndërhyrjes dhe administrimit të asaj pjesë territoriale të përkufizuar si "njësi strukturore" duke mbajtur në konsideratë treguesit e mëposhtëm:

   a. Klasifikimin e mundësive të zhvillimit në përputhje me mënyrat e ndërhyrjes në territor dhe përdorimet e lejuara të tokes për secilën njësi sipas përcaktimeve të këtij plani dhe kësaj rregullore.

   b. Krijimin e kompaktësisë hapësinore për secilën tipologji ndërhyrje në territor për çdo njësi strukturore.

   c. Njëtrajtshmëri të treguesve të zhvillimit për çdo sipërfaqe të studiuar të territorit sipas secilit përdorim.

4.3 NENI 18 - Përcaktimi i njësive strukturore për të cilat hartohet PDV

1. Njësitë strukturore për të cilat është e detyrueshme të hartohet PDV-ja janë

përcaktuar nga plani duke mbajtur në konsideratë treguesit si vijon:

a. Njësi strukturore me zhvillim intensiv, në presion zhvillimi, njësi strukturore banimi sipas kategorisë A të përdorimeve bazë, njësi strukturore të reja dhe të pazhvilluara, ose bujqësore dhe/ose natyrore që janë klasifikuar në sistemin e urbanizueshëm nga PPV dhe që ndahen për qëllime zhvillimi, si edhe njësi strukturore të degraduara të sistemit urban të cilat janë subjekt i programeve të rigjenerimit urban;

b. Janë propozim për rizonim dhe ndryshim të përdorimit të lejuar të tokës dhe strukturave në të, sipas kategorive bazë të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores të planifikimit" dhe nënkategorive më të detajuara të përcaktuara në PPV dhe kjo rregullore, dhe janë klasifikuar ose mund të klasifikohen si përdorime të kushtëzuara dhe/ose të ndaluara për njësinë strukturore ku propozohen të zhvillohen;

c. Synimi i zhvillimeve në njësinë e përzgjedhur, përbën një projekt publik të rëndësishëm të tillë si, program konservimi, program rigjenerimi, të propozuar nga autoriteti i planifikimit në instrumentet e përgjithshme të planifikimit në fuqi, ose të identifikuar bazuar në politikën vendore të planifikimit apo në strategjitë e zhvillimit të miratuara në këshillin e njësisë së qeverisjes vendore, ose në politikat dhe programet sektoriale në nivel qëndror;

d. Mbi 30% e sipërfaqes dhe/ose sipërfaqes së ndërtimit të njësisë strukturore ose zonës me prioritet zhvillimi, preket nga zhvillimi.

4.4 NENI 19 - Rregulla për njësitë strukturore për të cilat parashikohet zhvillimi i PDV-ve

1. Sipërfaqja totale e një njësie strukturore është sipërfaqja minimale e territorit, që i nënshtrohet hartimit të PDV-së, sipas përcaktimeve të hartës së zonimit të përdorimit të tokës të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe kësaj rregullore zhvillimi.

2. Sipërfaqja totale e të gjitha parcelave publike dhe private të përfshira brenda kufirit të njësisë strukturore duhet të planifikohen, menaxhohen dhe zhvillohen sipas procedurave dhe kushteve të legjislacionit në fuqi si dhe ato të përcaktuara nga ky plan dhe kjo rregullore.

3. Planet e Detajuara Vendore duhet të sigurojnë zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, nëpërmjet respektimit të instrumenteve të planifikimit të përcaktuara nga kuadri ligjor në fushën e planifikimit dhe rregullat dhe kushtet e përcaktuara nga ky plan dhe kjo rregullore zhvillimi.

4. Për parcelat të cilat shtrihen përtej kufijve të njësisë strukturore do të gjykohet

nga autoritetet vendore sipas rastit mundësia e zhvillimit të tyre në njësinë pararendëse për të cilën hartohet PDV-ja, duke respektuar kushtet e përcaktuara në Pikën 6 të Nenit 38 të kësaj rregullore zhvillimi.

5. Subjekti privat apo publik (zhvilluesi/investitori), që kërkon fillimin e proçesit të hartimit të PDV-së, duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm sipas përcaktimeve dhe proçedurave të përcaktuara nga ligji dhe aktet nënligjore në fuqi.

6. Madhësia minimale e parcelës të cilës i lejohet e drejta për zhvillim sipas kushteve të përcaktuara nga plani apo kjo rregullore zhvillimi për të gjitha njësitë subjekt PDV-je përcaktohet nga PDV e njësisë përkatëse dhe është e detyrueshme në të gjitha rastet. Në të gjitha rastet e tjera jepen nga pasaportat e njësive përkatëse, me tolerancën ±10%.

7. Autoritetet vendore kanë të drejtën e nënshtrimit të një propozimi për zhvillim në përkufizimin e të drejtës për zhvillim sipas përcaktimit të një plani të detajuar vendor, kur kërkohet nga PPV apo nga një politikë e caktuar vendore rritja e cilësisë së zhvillimit dhe lehtësimi i zhvillimit të njësive strukturore urbane të mëdha, e realizueshme kjo si nëpërmjet planifikimit më të mirë e të integruar dhe administrimit të tyre, ashtu edhe menaxhimit të zhvillimit (jo të copëzuar).

8. Autoritetet vendore kanë detyrimin e nënshtrimit të një propozimi për zhvillim në proçesin e hartimit të PDV-së, edhe nëse ky plan dhe kjo rregullore nuk e kanë paracaktuar, kur mbi 30% e sipërfaqes të njësisë strukturore preket nga zhvillimi, apo zhvillimi përkufizon projekte të rëndësishme private apo publike të tillë si, programe konservimi, program rigjenerimi, komplekse turistike, etj, të propozuara ose të identifikuara bazuar në politikën vendore të planifikimit apo në strategjitë e zhvillimit të miratuara në këshillin e njësisë së qeverisjes vendore, strategji zhvillimi komplekse që prekin në mënyrë të ndërthurur, njëkohësisht, territore të dy apo më shumë njësive strukturore të cilat bashkërisht i kalojnë raportet e 30% të sipërfaqes totale të këtyre njësive, apo në politikat dhe programet sektoriale në nivel qëndror.

9. Plani i Detajuar Vendor për një njësi strukturore, ruan të drejtën e propozimit dhe kushtëzimit të bashkimit dhe/ose nënndarjes të parcelave për qëllime zhvillimi, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, për ato raste të cilat identifikohen si të domosdoshme bazuar në politikën vendore të planifikimit apo në ato raste kur është e nevojshme ruajtja e tipologjive ekzistuese të strukturave në territorin subjekt studimi.

4.5 NENI 20 - Rregulla dhe kritere të përgjithshme për ndërtimin e objekteve për qëllime

bujqësore

1. Për të gjitha objektet për qëllime bujqësore duhet të respektohen distancat nga rrugët, hekurudhat, aeroportet, linjat e tensionit të lartë e çdo infrastrukturë tjetër publike dhe distancat nga kanalet ujitëse e kulluese, si dhe brigjet e lumenjve, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

2. Zhvillimi dhe ndërtimi në territoret e sistemit bujqësor kryhet vetëm në bazë të përcaktimeve dhe rregullave të parashikuara nga ky plan dhe kjo rregullore zhvillimi, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9244, datë 16.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", Vendimit të Keshillit të Ministrave nr. 655, datë 28.7.2010, "Për rregullat dhe proçedurat e ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës".

3. Në njësitë që i përkasin kategorisë së përdorimit bujqësi, dhe sipas tabelave parametrike të kësaj rregullore, zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore për mbrojtjen e tokës dhe ndërtimin në tokë bujqësore. Në këto zona:

   a. Ndërtimet për qëllime, apo në funksion të aktivitetit bujqësor e blegtoral, të cilat kryhen në tokë bujqësore, në të paktën një nga rastet e mëposhtme, do të përcaktohen si zhvillime me karakter tranzitor në tokë bujqësore dhe për këtë qëllim nuk do të ndryshojë kategoria e parcelës përkatëse e ndërtimit/zhvillimit nga bujqësore në urbane, në rastet kur zhvillimi i propozuar shtrihet:

      i. në brendësi të tokës bujqësore dhe/ose larg rrugëve interurbane,

      ii. larg fshatrave, qëndrave urbane dhe/ose qëndrave të banuara në tërësi,

      iii. ose në zona të cilat nuk përcaktohen për ndryshim të kategorisë së sistemit bujqësor të cilit i përkasin në një tjetër sistem.

   b. Kur Bashkia Tropojë duhet të ndërtojë rrugë shërbimi në tokë bujqësore me qëllim sigurimin e aksesit për aktivitete në funksion të bujqësisë dhe blegtorisë, apo zhvillimit ekonomik mbi bazën e bujqësisë dhe blegtorisë, atëherë ato do të projektohen mbi gjurmën e rrugës bujqësore ekzistuese, duke parashikuar në të dy krahët sistemin e kanaleve kulluese e ujitëse, sipas kategorive që lejohen në ligj. Rruga e shërbimit do të ketë minimalisht 2 korsi pa trotuare. Korsitë planifikohen në vlerën e tyre minimale të gjerësisë sipas legjislacionit në fuqi për rrugët. Nuk lejohet ndërtimi i rrugës së shërbimit mbi tokë bujqësore.

   c. Rrugët bujqësore të ndërtuara përgjatë kanaleve kulluese e vaditëse sipas kategorive përkatëse dhe legjislacionit në fuqi për infrastrukturën e kullimit dhe ujitjes, ruhen të pacënuara nga ndërtime dhe ndërhyrje të çdo lloji tjetër,

përveç atyre rikonstruktuese, rehabilituese, ristrukturuese. Çdo aktivitet që cënon funksionin e rrugës bujqësore është i paligjshëm

4. Lejet e ndërtimit për objektet e përcaktuara në nenin 30 të kësaj rregullore jepen vetëm pasi të jetë verifikuar ekzistenca e infrastrukturave të nevojshme, për sa u përket rrugëve lidhëse, elektricitetit dhe ujit të pijshëm ose marrjes përsipër të realizimit të tyre nga investitori njëkohësisht me ndërtimin e objekteve të sipërpërmendura.

5. Leja e ndërtimit për objektet e kësaj kategorie, jepet vetëm me kushtin e ruajtjes dhe mosndryshimit të destinacionit për qëllim bujqësor/blegtoral të objektit për të cilin është lëshuar.

6. Për qëllim të llogaritjes së vëllimit/sipërfaqes së ndërtimit, në intensitetin e ndërtimit përfshihet ngastra ose bllok ngastrash edhe kur ndahen nga rrugë, kanale apo kufij të tjerë natyralë, në pronësi apo përdorim. Lëshimi i lejes së ndërtimit për objektet, sipas kësaj pike, shteron mundësinë e ndërtimit në të gjitha ngastrat që janë përdorur për llogaritjen e vëllimit/sipërfaqes së ndërtimit.

7. Ndërtimet e lejuara në tokë bujqësore nuk duhet në asnjë rast të cenojnë infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit të tokës bujqësore.

8. Ndërtimi i shtëpive individuale në toka natyrore apo bujqësore lejohet vetëm kur është identifikikuar në mënyrë specifike në plan.

9. Në rastet kur një pronë e përfshirë nga ky plan brenda njësive me përdorim *natyrë* (N) ose *bujqësi* (B), gëzon statusin "truall" para miratimit të këtij plani, lejohet zbatimi i kësaj pike (8) duke respektuar këto përcaktime:
   - h maksimale 2.5 kate;
   - sipërfaqe minimale e pronës = 300m2;
   - sipërfaqe më e madhe e lejuar e gjurmës së ndërtesës = 150m2.

4.6 NENI 21 - Njësitë strukturore me përdorim bujqësi dhe natyrë

1. Në të gjitha njësitë strukturore me përdorim natyrë (N) apo me përdorim të përzier bujqësi dhe natyrë (BN), lejohet ndryshimi i raporteve mes të dy përdorimeve, vetëm në rastet e parashikuara nga pika 3 e Nenit 3.

4.7 NENI 22 - Mënyra e ndërhyrjes në territor sipas përdorimeve të lejuara të tokës dhe të strukturave në të

1. Mënyra e ndërhyrjes (zhvillimit ose kufizimit të zhvillimit) në njësitë strukturore, evidentojnë objektivat e ndërhyrjes në strukturën urbane ekzistuese që duhet të

arrihen për njësitë përkatëse. Këto mënyra përfshijnë:

a. *Rizhvillim/Zhvillim*

b. *Konsolidim*

c. *Konservim*

d. *Ristrukturim/rigjenerim*

2. Në vijim të pikës 1 të këtij neni, mënyrat e ndërhyrjes në njësitë strukturore nënkuptojnë konceptet si vijon:

a. *"Rizhvillim"* – apo zhvillimi, janë mënyra veprimi në proçesin e planifikimit, në njësi struktrore me dendësi të ulët deri të lartë banimi dhe/ose përdorimi, të cilat kanë për qëllim të rivlerësojnë treguesit e zhvillimit të njësisë strukturore dhe të transformojnë strukturën ekzistuese apo të planifikuar urbane.

b. *"Konsolidimi urban"* - proçesi i densifikimit dhe mbushjes urbane të një njësie strukturore apo të një pjesë të saj, pjesërisht të zhvilluar dhe kryesisht homogjene për nga kategoria e përdorimit të tokës, me struktura të të njëjtit karakter, funksion, përdorim, tregues të planifikimit, zhvillimit dhe ndërtimit me ato të pronave/strukturave me të cilat kufizohet. Këshillohet ruajtja e të njëjtës tipologji hapsinore dhe/ose strukturash për strukturat e reja në raport me ato ekzistuese gjatë ndërhyrjeve në territor sipas kësaj mënyre.

c. *"Konservim"* - përfshin tërësinë e veprimeve të ndërmarra nga plani të cilat synojnë ruajtjen e pasurisë urbane, ekonomike dhe sociale si edhe të vlerave historike, kulturore dhe mjedisore në kohë, sipas përcaktimeve të këtij Plani të Përgjitshëm Vendor dhe të legjislacionit të posaçëm në fuqi;

d. *"Ristrukturim/Rigjenerim"* - përfshin veprimet në proçesin e planifikimit, të cilat kanë për qëllim të rivlerësojnë dhe ripërtërijnë strukturën ekzistuese urbane dhe të hapësirave publike, të cilat nuk ndryshojnë kategorinë e përdorimit të tokës/ strukturës, karakterin, funksionin si dhe treguesit e planifikimit. Ky proces nuk parashikon zhvillimin apo rizhvillimin e hapësirave apo parcelave, perveç rasteve kur parashikohen ndërhyrje të kombinuara për njësinë specifike sipas përcaktimeve të këtij plani dhe kësaj rregullore zhvillimi. Proçesi i rigjenerimit synon gjithashtu rigjallërimin e tipologjive ekzistuese hapësinore, të përdorimeve bujqësore, natyrore, etj, duke ruajtur karakterin ekzistues dhe stimuluar zhvillimin ekonomik në territor.

3. Në mënyrë që të theksohet dinamika urbane do të përcaktohen sipas rasteve edhe ndërhyrje të kombinuara për njësi strukturore me karakteristika të veçanta zhvillimi ekzistues, si p.sh. "Ristrukturim dhe Konsolidim" apo "Ristrukturim dhe Konservim".
4. Mënyra e ndërhyrjes për çdo tipologji njësie strukturore do të përcaktohet në Kreun XI, të kësaj rregullore dhe në të gjitha rastet do të kushtëzojnë kushtet e trajtimit të territorit të ndërlidhura me të drejtën e ndërhyrjes në territor.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT · TIRANË · SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT · TIRANË · SEKRETARIA

5 PLANIFIKIMI NË NIVEL VENDOR

5.1 NENI 23 - Përkufizime dhe rregulla për njësitë strukturore që nuk janë subjekt hartimi i planeve të detajuara vendore

1. Çdo kërkesë zhvillimi për të gjitha njësitë strukturore për të cilat nuk parashikohet nevoja e hartimit të planeve të detajuara vendore do të procedohet direkt në fazën e Lejes së Zhvillimit, ku aplikanti do të duhet të paraqesë kërkesën për zhvillim sipas përkufizimeve ligjore të përcaktuara në rregulloren e zhvillimit, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 408, datë 13.05.2015.

2. Në rastet kur projekti përfshin zhvillimin e njëkohshëm të më shumë se 4 strukturave apo të më shumë se një tipologjie përdorimi të tokës dhe strukturave në të, atëherë aplikimi për Leje Zhvillimi do të përfshijë edhe studimin e volumetrisë urbane, e cila do të definojë mënyrat e ndërhyrjes në territor sipas përcaktimeve të kësaj rregullore zhvillimi.

5.2 NENI 24 - Leja e zhvillimit

1. Leja e Zhvillimit nënkupton instrumentin e kontrollit të zhvillimit të territorit, në kuptim të këtij neni dhe të përcaktimeve ligjore sipas ligjit 107/2014, për "Planifikimin e Territorit" (i ndryshuar) dhe "Rregullores së Zhvillimit" miratuar me V.K.M., nr. 408, datë 13.05.2015 (i ndryshuar).

2. Dokumenti i Lejes së Zhvillimit do të përmbajë informacionin bazë të përcaktuar në aktet nënligjore në zbatim të ligjit. Në rastet kur Leja e Zhvillimit kërkohet pas miratimit të Planit të Detajuar Vendor, Leja e Zhvillimit mund të jetë edhe ekstrakt i PDV-së, me kushtin që të përmbajë informacionin bazë të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, për zonën e menaxhimit për të cilën kërkohet Leja e Zhvillimit.

3. Në respektim të pikës 2 të këtij neni, aplikanti lejohet të vijojë me procedurat e nevojshme për kërkesën e lejes së ndërtimit bazuar në PDV-në e miratuar për njësinë dhe zonën e zhvillimit përkatëse për të cilën interesohet. Informacionin bazë mbi kushtet e zhvillimit dhe informacionin bazë që përmban ekstrakti i Lejes së Zhvillimit apo PDV mund ta përftojë nga mjetet e informimit të qytetarëve apo RKPT (Regjistri Kombëtar i Planifikimit të Territorit).

4. Për procedurën e shqyrtimit dhe miratimit të Lejes të Zhvillimit do të veprohet sipas ligjit të planifikimit dhe rregulloreve në funksion të tij, në fuqi.

5.3 NENI 25 - Hartimi i planeve të detajuara vendore

1. Njësitë strukturore të cilat do ti nënshtrohen hartimit të PDV janë të përcaktuara në hartën treguese dhe në pasaportat parametrike të treguesve të zhvillimit në vijim të kësaj rregulloreje.

2. Kjo rregullore përcakton:

   a. Njësi strukturore ku mund të proçedohet me leje zhvillimi dhe në mungesë të PDV, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje zhvillimi, këtij plani dhe akteve ligjore në fuqi.

   b. Njësi strukturore të cilat do të zhvillohen vetëm pas hartimit të Planeve të detajuara vendore si dhe kushtet e përgjithshme që këto PDV duhet të respektojnë.

   c. Mënyra ndërhyrje në territor të cilave u jepet e drejtë zhvillimi pa PDV edhe nëse rregullat për njësinë përcaktojnë përcaktimin e mundësive të zhvillimit nëpërmjet hartimit të Planeve të Detajuara Vendore.

3. Autoritetet vendore të planifikimit, me përjashtim të rasteve të veçanta të përcaktuara në këtë rregullore, nuk lejohet të proçedojnë me leje zhvillimi apo ndërtimi për ato njësi strukturore që parashikohet të hartohet PDV sipas Planit të Përgjithshëm Vendor dhe kësaj rregulloreje zhvillimi përpara miratimit të planit të detajuar vendor për njësinë përkatëse.

5.4 NENI 26 - Kushte dhe norma për hartimin e Planeve të Detajuara Vendore

1. Plani i detajuar vendor sip as përcaktimit të ligjit të planifikimit dhe rregulloreve në funksion të tij, është procesi i detajuar i planifikimit i cili siguron implementimin dhe respektimin e instrumenteve vendore dhe kombëtare të planifikimit për një apo më shumë njësi strukturore.

2. Në kushtet e hartimit të PDV-së, territori në studim, i përbërë nga një apo disa njësi strukturore, do të nën-ndahet për efekt detajimi në nënzona sipas këtij rendi hierarkik:

   a. Zonat e zhvillimit dhe ristrukturimit, të cilat përfshijnë nën-ndarjen bazë për qëllimin e analizës territoriale dhe shpërndarjen parametrike të treguesve të zhvillimit për secilën zonë zhvillimi

   b. Zonat e menaxhimit, të cilat do të formësohen sipas projektimit urban dhe planit të menaxhimit të pronave në funksion të tij

3. Hartimi i PDV-së do të sigurojë shpërndarjen e barabartë proporcionalisht të treguesve të zhvillimit për secilën zonë zhvillimi.

4. Pronat me përdorim publik, të cilat nuk përfshijnë rrugë dhe sheshe ekzistuese dhe të formuara definitivisht, do të përfshihen në zonimin për zhvillim dhe do të konsiderohet me të drejta të barabarta zhvillimi si të gjitha pronat e tjera private. Në këto raste mbi pronat me përdorim publik do të delegohen të drejta zhvillimi proporcionalisht të barabarta me të gjitha pronat private, pjesë të zonave të zhvillimit. Këto të drejta do të konservohen për përdorim publik. Autoritetet vendore të planifikimit mund ti delegojnë këto të drejta në zhvillimet kufitare për gjenerimin e PPP, me kushtin e përfitimit sipas trajtës dhe natyrës të parcelave të tjera kufitare në zonë.

5. Zonat e ristrukturimit do të përcaktohen nga analiza e territorit subjekt hartimi i PDV-së, duke përkufizuar strukturat të cilat do të konsiderohen situatë e formuar dhe parcelat e manaxhuara apo hapësirat e hapura në funksion të tyre.

6. Strukturat të cilat do të konsiderohen si situatë e formuar, do jenë ato struktura të cilat i përkasin hierarkisë më të ulët të lartësisë, sipas përcaktimeve të pikës 4 të Nenit 41 të kësaj rregulloreje. Në rastet kur një strukturë ekzistuese më e lartë kërkon të drejta rizhvillimi, atëherë struktura dhe parcela në funksion të saj do futet për rizhvillim sipas përcaktimeve të këtij plani dhe kësaj rregulloreje zhvillimi, edhe në rastet kur PDV është miratuar. Përfshirja e strukturave të reja për qëllime rizhvillimi, do të reflektohet në rishpërndarjen e treguesve të zhvillimit sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje dhe kushteve ligjore për rishikimin dhe miratimin e PDV-së.

7. Përcaktimi i zonave të zhvillimit dhe risktrukturimit do të bëhet bazuar në rrjetin rrugor ekzistues dhe të propozuar, apo sipas rastit në akset e pronave publike, kur këto të fundit përkufizojnë apo ndihmojnë në nën-ndarjen zonale për qëllime zhvillimi.

8. Rrjeti rrugor i propozuar nga ky plan apo nga projektuesi gjatë procesit të hartimit të planit të detajuar vendor, do të shërbejë kryesisht për nën-ndarjen e zonave të zhvillimit, përjashtuar zonat e ristrukturimit të cilat sipas rastit mund të ndahen nga zonat e zhvillimit edhe sipas përkufizimit të parcelave të menaxhuara apo përfshira në zhvillimin e situatës të formuar.

9. Gjatë përkufizimit të zonave për zhvillim, projektuesi të ketë në konsideratë nevojat për plotësimin e njësisë me infrastrukturën e shërbimeve e cila kërkon sipërfaqe kompaktë për realizimin e implementimit të tyre. Në të tilla raste, zonat e rizhvillimit duhet të jenë të mëdha në mënyrë që të realizojnë gjenerimin e sipërfaqeve publike kompakte në shërbim të realizimit të infrastrukturës së shërbimeve të nevojshme në zonë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

10. Në rastet kur rrezet e mbulimit prekin disa njësi paralelisht, autoritetet vendore do të gjykojnë nëse njësia për të cilën kërkohet zhvillimi është e përshtatshme për realizimin e infrastrukturës së kërkuar, në të kundërt, infrastruktura do të sigurohet në njësinë kufitare sipas standardeve. Në këto raste, projektuesit t'i kërkohet të hartojë PDV paralelisht për të dy njësitë strukturore të cilat i përgjigjen si interesit për zhvillim ashtu dhe nevojave të përcaktimit të hapësirave për realizimin e infrastrukturës së shërbimeve në territor.

11. Projektimi urban për secilën zonë menaxhimi, pjesë të një zonë zhvillimi, duhet të mundësojë realizimin e mundësive proporcionalisht të barabarta të zhvillimit. Realizim proporcionalisht i barabartë do të thotë një diferencë jo më e madhe se 0.5 për intensitetin e secilës zonë menaxhimi pjesë të një zonë zhvillimi.

12. Në rastet kur në një zonë zhvillimi, si pasojë e situatës së formuar në territor, apo e formës së veçantë të një apo më shumë zonash menaxhimi, nuk arrihet nga projektimi urban realizimi i mundësive të zhvillimit proporcionalisht të barabarta për secilën zonë menaxhimi, atëherë projektuesi duhet ta argumentojë teknikisht pamundësinë duke paraqitur pranë autoriteteve vendore të planifikimit më shumë se dy variante zgjidhje të projektimit urban në funksion të përafrimit të diferencës mes zonave të menaxhimit.

5.5 NENI 27 - Përmbajtja dhe procedura e miratimit të PDV-ve

1. Përmbajtja dhe formati i planit të detajuar vendor përcaktohet nga autoritetet e planifikimit, në përputhje me kushtet dhe përcaktimet ligjore të kësaj rregulloreje dhe rregullores së planifikimit në fuqi.

2. Procedura e miratimit të PDV do të përcaktohet me rregullore të veçantë nga autoritetet vendore të planifikimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6 PËRKUFIZIME DHE KUSHTE PLANIFIKIMI DHE KONTROLLI TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

6 PËRKUFIZIME DHE KUSHTE PLANIFIKIMI DHE KONTROLLI TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

6.1 NENI 28 - Tipologjitë hapësinore

1. Ndërtesat që ndodhen në territorin e bashkisë formësojnë disa tipologji hapsinore:

   a. *Struktura vetjake* – përfshin tipologjinë e strukturave individuale të vendosura në hapësirën territoriale të çdo parcele, e përdorimeve të ndryshme

   b. *Struktura gjysëm-vetjake* – përfshin kryesisht vendosjen e bashkuar të dy strukturave të përdorimit banim, të cilat nuk krijojnë zinxhirin e strukturave të vendosura në rresht sipas tipologjisë urbane në formë të bashkëlidhur

   c. *Struktura të grupuara vetjake dhe gjysëm-vetjake* – ku përfshihen strukturat e grupuara në terren të pjerrët, në trajtë të ndryshme hapsinore në raport me strukturat në terrene të sheshta.

   d. *Struktura të bashkëlidhura* – përfshin tipologjinë e strukturave të çdo përdorimi, të organizuara dhe vendosura në territor në rresht, të bashkëlidhura, ku përfshihen gjithmonë 3 e më shumë njësi përdorimi.

   e. *Struktura gjatësore* – përfshin kryesisht struktura të karakterit të mesëm dhe/ose të lartë, të vendosura në objekte të cilat kanë brinjë gjatësore në plan më të gjata se lartësia e strukturës.

   f. *Struktura të tipit kullë* – përfshin strukturat e lartësisë të mesme dhe të lartë, individuale, ku lartësia e strukturës tejkalon brinjët e strukturës në plan.

6.2 NENI 29 - Tipologjitë e strukturave

1. Në kuptim të kësaj rregullore zhvillimi dhe këtij plani të përgjithshëm vendor, analiza e territorit dhe e tipologjive hapësinore të studiuara në territor përfshijnë një varietet tipologjish të pjesës më të madhe të strukturave që gjenden në territorin administrativ. Në këtë kuptim, këto struktura janë:

   a. *Banesa historike:* Shtëpi tradicionale të ndërtuara me gurë e dru, që datojnë para viteve '40. Këto objekte kanë pak ndikime nga arkitektura e huaj, si më të izoluara që ishin dhe kanë ruajtur gjuhen tradicionale të arkitekturës. Ato janë në terrene bujqësore të rrethuara me gardhe druri dhe gjenden kryesisht në zona të izoluara.

      - *Shtëpi e veçuar (një kat, dy kate)*
      - *Shtëpi gjysmë e veçuar*

   b. *Kulla:* Banesa të vjetra guri, karakteristike për zonën që janë ndërtuar para viteve '40. Këto janë shtëpi të fortifikuara, që shërbenin për mbrojtje gjatë rasteve të

rrezikut dhe shpesh kanë qenë vatra të rezistencës kundër pushtuesve. Megjithëse tradicionale, kulla ishte shenjë mirëqënieje dhe jo të gjitha familjet e kishin mundësinë t'i ndërtonin. Kulla vendoset në mes të parcelës private (zakonisht bujqësore) e cilla kishte rrethim me gardh druri. Një pjesë e tyre sot janë kthyer në shtëpi muze.

c. *Banesa socialiste:* Të ndërtuara pas 1946 nga regjimi Komunist, këto tipe shtëpish variojnë mes tipologjive një katëshe dhe shtëpive dy katëshe apo atyre të vendosura zinxhir. Shtëpitë e vogla një-katëshe përbëhen nga një hyrje/portik, një holl dhe katër dhoma kryesore (e ditës, e gatimit, 2 dhoma gjumi) dhe një banjë. Parcela është zakonisht rreth 400 m2 dhe përgjithësisht e rrethuar me gardh metalik. Vitet e fundit këto shtëpi kanë pësuar shtesa në pjesët e jashtme të strukturave të cilat në disa raste e bëjnë të pamundur evidentimin e formës origjinale të strukturës.

- *Shtëpi e veçuar (një kat, dy kate)*
- *Shtëpi gjysmë të veçuara (një kat, dy kate)*
- *Shtëpi në rresht*

d. *Ndertesa socialiste me apartamente:* blloku i apartamenteve socialiste është një tipologji ndërtesash tip, kryesisht të përbëra nga një shkallë qëndrore. Këto struktura gjenden të vendosura në mënyrë individuale në modelin e tipit kullë, apo në seri, duke formësuar struktura lineare përgjatë rrugëve kryesore. Hyrja në këto ndërtesa është pa derë dhe kafazët e shkallëve janë të aksesueshme në mënyrë të atillë sa e sjellin përkatësinë publike të ndjeshme deri të dera e apartamentit. Këto struktura bazohen në dy tipologji kryesore ndërtimi: tulla dhe beton. Pas viteve 90, shumë nga këto ndërtesa kanë pësuar transformime në mënyra të ndryshme ose, në zonat më rurale, janë braktisur plotësisht.

e. *Banesa bashkëkohore:* Të ndërtuara sidomos gjatë periudhës së 25 viteve të fundit, shtëpitë familjare një ose disa-katëshe gjenden kudo përgjatë territorit, kryesisht në afërsi të qëndrave kryesore urbane apo përgjatë infrastrukturës rrugore kryesore. Këto shtëpi përbëhen nga struktura b/a dhe mure tullash termike. Ndonjëherë këto shtëpi paraqesin pjesë të papërfunduar në një kat të tërë.

- Shtëpi të veçuara (një kat, dy kate, tre kate, katër kate)

f. *Ndërtesa bashkekohore me apartamente:* Të ndërtuara pas 1992, ndërtesat kolektive shumëkatëshe të tipologjive, përmasave dhe lartësive të ndryshme gjendet vetëm në Bajram Curri. Këto ndërtesa janë tip kulle, si agregate apo të vetmuara, të ulëta apo të larta, me struktura b/a dhe me tulla termike (për kohën). Katet përdhe zakonisht janë me funksione ekonomike. Çdo kat përbëhet nga një

apo më shumë apartamente në varësi të dimensionit të katit, zakonisht me një shkallë dhe një ashensor.

g. *Stane:* Vendbanime të ngritura në bjeshkë dhe shpatet e maleve që përdoren nga banorët gjatë muajve të verës për blegtorinë. Familjarët zhvendosen për një periudhë 3-4 muaj në këto banesa, ku secili ka një detyrë të caktuar për mbarëvajtjen e jetesës. Duksh me blegtorinë, dikush më gatimin, pastrimin e mirëmbajtjen, dikush më sigurimin e materialeve të nevojshmë, dikush më mbledhjen e bimëve mjekësore, etj. Periudha e jetës në stan është një aspekt i rëndësishëm i ekonomisë shtëpiake për rajonin.

h. *Shërbime publike:* Shpërndarje të mirash materiale, shëndetësi, turizëm, transport, shërbime financiare dhe administrative, arsim, etj. Shkëmbim vlerash jomateriale ku përfitohet shërbimi dhe jo një objekt fizik, në pronësi të shtetit.

a. *Shërbime publike në shkallë të vogël: (Përfshirë, por jo kufizuar në):*

- Ambulancë
- Shërbim postar
- Stacion policie
- Objekte kulti
- Njësi administrative vendore
- Treg
- Shkolla 9-vjeçare
- Kopshte
- Çerdhe
- Varreza

b. *Shërbime publike në shkallë të madhe: (Përfshirë, por jo kufizuar në):*

- Shkollë e nevojave të veçanta
- Bibliotekë
- Qendra të përgatitjes profesionale
- Qendër kulturore
- Stadium
- Ndërtesa ushtarake
- Pallati i sportit
- Azili i pleqve
- Museu
- Godina e Bashkisë
- Spital
- Shkolla të mesme

9. *Hapësirë publike:* Hapësira të lira nga ndërtimet për pushim, çlodhje, lojra, grumbullime, aktivitete sportive e shoqërore, në funksion të mirëqënies sociale, të ndërtuara, mirëmbajtura dhe të zotëruara nga shteti. (Përfshirë, por jo kufizuar në)

    - Sheshe
    - Kopshte
    - Kënde lojrash
    - Terrene sportive
    - Bahçe (të mbjella)

10. *Zonë/Trashëgimi arkeologjike:* Objekte historike me vlera të larta kulturore, të mbrojtura e të mirëmbajtura nga shteti. Ato mund të jenë banesa historike, objekte kulti me vlera të veçanta apo fortifikime të vjetra. Edhe pse kalatë përfshihen në këtë listë, një pjesë e madhe e tyre janë të rrënuara dhe është e vështirë të vërehen.

11. *Ndërtesa tregtare/ industriale:* Aktivitete ekonomike të vogla strehohen kudo në struktura të vogla apo në katet e para të ndërtesave mikse. Këto aktivitete ekonomike përfshijnë përdorime kafesh, ushqimoresh, e dyqanesh të ndryshme, kryesisht të vendosura pranë qëndrave dhe përgjatë rrugëve kryesore. Ndërkohë që tipologjia e strukturave të mëdha korrespondon me strukturat industriale, në të cilat zhvillohen aktivitete ekonomike si fasoneri, përpunime, magazinime apo strukura logjistike, etj. Kjo tipologji ndërtesash gjendet e ndërtuar prej strukturash metalike e vetrata xhami apo b/a, në rastin e ndërtesave të vjetra socialiste, të përshtatura e privatizuara pas viteve '90.

    a. *Ndërtesa tregtare/ industriale në shkallë të vogël: (Përfshirë, por jo kufizuar në):*

    - Dyqane të vogla
    - Bare dhe restaurante
    - Markëtë
    - Pika karburanti

    b. *Ndërtesa tregtare/ industriale në shkallë të madhe: (Përfshirë, por jo kufizuar në):*

    - Supermarkëtë
    - Magazina
    - Gurore
    - Miniera

12. *Shërbime private:* Shërbime financiare, turizëm, shpërndarje, shëndetësi, arsim, etj. Shkëmbim vlerash jomateriale, ku blihet shërbimi dhe jo objekti fizik. Në pronësi të një ose më shumë individëve.

    a. *Shërbime private në shkallë të vogël*: (Përfshirë, por jo kufizuar në):

- Klinika private
- Bankomate dhe shërbime bankare
- Shtëpi pushimi
- Këmbim valutor
- Kompani telefonike
- Qendra interneti
- Zyra të vogla
- Shërbime funerare
- Oficina e lavazhe
- Farmaci
- Agroturizëm

b. *12.2 Shërbime private në shkallë të madhe*: (Përfshirë, por jo kufizuar në):

- Hotel
- Zyra qendrore kompanish
- Zyra qëndrore të bankave
- Kompani automjetesh

13. *Ndërtesa ndihmëse për bujqësinë:* Objekte të vogla private në ndihmë të bujqësisë. Ato vendosen në pronë private, zakonisht bujqësore dhe mund të jenë të veçuara ose pranë banesave. Ato përdoren për magazinimin e produkteve, depozitim materialesh të nevojshme për bujqësinë ose veglave të ndryshme dhe shpesh si strehë për kafshët. Ndërtesat janë përgjithësisht të vogla, të ndërtuara sipas nevojës me materiale të ndryshme që variojnë nga strukturat e lehta metalike e të drurit, të objekte më të rënda, prej tulle ose betoni. Ndonjëherë përshtaten dhe struktura të vjetra socialiste, të braktisura e të privatizuara.

6.3 NENI 30 - Tipologjitë e strukturave për prodhimin, ruajtjen, përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale që ndërtohen në tokë bujqësore

1. Në kuptimin e kësaj rregulloreje, përkufizimi dhe rregullat e zhvillimit të strukturave për prodhimin, ruajtjen, përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale që ndërtohen në tokë bujqësore, i referohen legjislacionit të posaçëm Ligjit nr.8752, datë 26.03.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave të adminisistrimit dhe mbrojtjes së tokës" të ndryshuar, dhe Vendimit të KM nr.283, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore", i ndryshuar, dhe përfshijnë edhe strukturat e identifikuara si vijon:

a. stallat për mbarështimin e kafshëve dhe objektet ndihmëse funksionale, të

cilat përfshijnë, por nuk kufizohen në depo silazhi, hangar, silos, ambiente për përpunimin e ushqimeve, sallë mjeljeje, padoqe, plehrishte, depozita uji;

b. serat me themele të vazhduara, të cilat janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën;

c. objektet ndihmëse funksionale të serave, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen në magazina për standardizimin e prodhimit dhe mbajtjen e pajisjeve, inputeve;

d. objektet për tharjen dhe trajtimin paraprak të nevojshëm të produkteve në kultura, të tilla si bimët medicinale etj.;

e. objektet për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, përfshirë dhe ato frigoriferike;

f. objekte për përpunimin e produkteve primare, bujqësore dhe blegtorale;

g. Thertoret.

h. Strukturat për agro-turizëm, me përdorim primar tregtimin e prodhimeve bujqësore. Këto struktura mund të përfshijnë zhvillimin e restoranteve, hoteleve, dhomave të shërbimit (si për agro-turizëm ashtu dhe për aktivitetin bujqësor), pika shitje dhe grumbullimi për produktet, mullinj/fabrika prodhimi vajrash ulliri/luledielli/misri/etj, vere, bimë medicinale, etj.

2. Këto struktura planifikohen bazuar në analizat e përvitshme të sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë, duke marrë në konsideratë dhe nevojat e zonave specifike. Në çdo rast ndërtimi i strukturave në përdorimin bujqësi do të kryhet në respektim të pikës 3 të këtij neni dhe legjislacionit në fuqi duke vlerësuar ndikimin në mjedis që sjell zhvillimi si dhe karakterin e ndërtimit i cili gjithmonë përmban detyrimin ti përgjigjet nevojave të kategorisë bujqësore.

3. Strukturat e përcaktuara në pikat e, f, g, mund të ndërtohen në njësitë me përdorimin e tokës sipas kategorisë IES.3.

4. Në tokat bujqësore strukturat e përcaktuara në pikat e, f, g, do të lejohen vetëm nëse fermeri apo kooperativa e investitorit privat përfhin një sipërfaqe minimale prej 10 Ha tokë bujqësore të kultivuar/kultivueshme. Përkatësia pronësore nuk është detyruese, por sipërfaqja minimale është kusht. Fermerët privatë/kooperativat/ sipërmarrësit, të cilët sigurojnë lëshimin e lejes së ndërtimit duhet të garantojnë kultivimin e sipërfaqes minimale prej 10 Ha, për një periudhë minimale prej 5 vitesh.

5. Strukturat e përcaktuara në pikat h mund të ndërtohen në njësitë me përdorimin e tokës sipas kategorisë IES.3. Në tokat bujqësore (kategoria B), këto struktura mund

të zhvillohen me (I) maksimal 0.06 me lartësi maksimale prej 2.5 kate, duke u bazuar në përcaktuimet e VKM Nr. 22 date 12.01.2018.

6.4 NENI 31 - Hapësira publike

1. Të gjitha hapësirat publike në shërbim të komunitetit, me menaxhim privat apo publik, të cilat përfshijnë rrugëkalime, mjedise të hapura dhe rekreative, sheshe, lulishte, parqe, etj., pavarësisht nga regjimi juridik i tokës dhe përtej përcaktimeve të pronës publike, sipas ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", janë në administrim të autoritetit vendor të Bashkisë Tropojë, në respektim të Nenit 4/1, të ligjit nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit".

2. Të gjitha planet e detajuara vendore, lejet e zhvillimit dhe lejet e ndërtimit, do të sigurojnë zhvillimin e hapësirave publike dhe atyre rekreative në respektim të përcaktimeve të këtij neni, të kësaj rregullore zhvillimi dhe kushteve ligjore ne fuqi.

3. Të gjitha zhvillimet e strukturave të banesave kolektive, do të sigurojnë realizimin e këndit të lojrave të fëmijëve, sipas grup-moshave, duke siguruar aktivitete sportive dhe rekreative sipas standardeve të projektimit, si pjesë e detyrueshme e sistemimeve të jashtme gjatë punimeve, sipas përcaktimeve të kësaj rregullore zhvillimi dhe kushteve të lejes së ndërtimit në respektim të këtij neni.

4. Në respektim të kushteve të këtij neni, dhe përparësisë së gjenerimit të hapësirave publike, në të gjitha ndërhyrjet për rizhvillim, në komplekset e banimit apo grup-strukturat e banesave kolektive, gjatë projektimit urban autoritetet e planifikimit të njësisë vendore do të kujdesen për gjenerimin e hapësirave publike kompakte në funksion të aktiviteteve rekreative dhe gjenerimit të sipërfaqeve me gjelbërim të lartë në blloqet e banimit.

6.5 NENI 32 - Rregulla dhe kritere të veçanta për ndërtimin e objekteve për qëllime bujqësore

1. Ndërtimet e objekteve ndihmëse funksionale për tipat sipas nenit 30, të kësaj rregulloreje, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

   b. Të zhvillohen në një kat të vetëm dhe të respektojnë lartësinë maksimale 6 metër në kulmin e mbulesës dhe 4,50 në ullukun horizontal, me përjashtim të oxhakëve, siloseve dhe strukturave që tejkalojnë këtë lartësi për shkak të karakteristikave teknike dhe përveç strukturave për agro - turizëm që mund të ndjekin rregullat e pasaportës përkatëse;

c. Të realizohen sipas tipologjive të përshtatshme për funksionin që do të kryejnë dhe që nuk lejojnë ndryshimin e destinacionit të përdorimit;

d. Të parashikohet zbatimi i strukturave të nevojshme për vënien në regjim, mbledhjen, kanalizimin, trajtimin dhe shkarkimin e ujërave të reshjeve dhe të atyre që janë rezultat i proceseve të impiantit.

2. Ndërtimet e reja të stallave lejohen me kusht që të garantojnë menaxhimin e jashtëqitjeve shtazore, me filtrim paraprak.

3. Stallat, që mbarështojnë mbi 50 njësi gjedhi mbi bazë ditore, duhet të kenë këto karakteristika:

d. Të respektojnë distancat minimale të mëposhtme:

- 20 metër nga kufijtë e pronës;
- 500 metër nga qendrat e banuara;
- 100 metër nga banesa më e afërt, e veçuar nga qendra urbane.

e. Të zhvillohen në një kat të vetëm dhe të respektojnë lartësinë maksimale 6 metër në kulmin e mbulesës dhe 4,50 në ullukun horizontal, me përjashtim të oxhakëve, siloseve dhe strukturave që tejkalojnë këtë lartësi për shkak të karakteristikave teknike dhe përveç strukturave për agro - turizëm që ndjekin rregullat e pasaportës përkatëse;

4. Për stallat që mbarështojnë 10-50 njësi gjedhi mbi bazë ditore, distancat minimale nga kufijtë e pronës janë 10 metër, ndërsa karakteristikat e tjera janë të njëjta me ato të përcaktuara në pikën 3.

5. Për stallat që mbarështojnë 5-10 njësi gjedhi mbi bazë ditore, distancat minimale nga kufijtë e pronës janë 5 metër, ndërsa nga banesa më e afërt 50 metër. Karakteristikat e tjera janë të njëjta me ato të përcaktuara në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 3, të këtij neni.

6. Strukturat për grumbullimin e jashtëqitjeve me origjinë shtazore duhet të vendosen në distancë jo më të vogël se 50 metër nga banesat për stallat me 5-10 njësi gjedhi dhe 100 metër për stallat më të mëdha.

7. Sipërfaqja e serave me themele të vazhduara, të cilat janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën, nuk duhet të tejkalojë 70% të sipërfaqes së pronës.

8. Për serat e përcaktuara në pikën 7 duhet të respektohen distancat e mëposhtme:

a. jo më pak se 5 metër nga banesat ekzistuese në të njëjtën ngastër dhe 10 metër nga banesat e tjera;

b. jo më pak se 3 m nga kufiri i pronës.

9. Për serat e tipave të tjera, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën, nuk kërkohet pajisja me një leje ndërtimi dhe ato janë objekt i një deklarate paraprake për kryerje punimesh. Distancat për ndërtimin e tyre janë të njëjta me ato të përcaktuara në pikën 8 të këtij neni.

10. Ndërtimet e objekteve për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, përfshirë dhe ato për tharjen e trajtimin paraprak të produkteve bujqësore, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

    a. Vëllimi maksimal i objektit të mos tejkalojë intensitetin e ndërtimit prej 1 m^3/m^2;

    b. Të respektojnë distancat minimale 7 metër nga kufijtë e pronës dhe 10 m nga ndërtesa të tjera.

11. Ndërtimet e objekteve për thertore duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

    a. Vëllimi maksimal i objektit të mos tejkalojë intensitetin e ndërtimit prej 1 m^3/m^2;

    b. Të respektojnë distancat minimale të mëposhtme:

    - 20 metër nga kufijtë e pronës;
    - 500 metër nga qendrat e banuara;
    - 100 metër nga banesa më e afërt, e veçuar nga qendra urbane.

12. Rregullat dhe kriteret e përcaktuara në të gjitha pikat e këtij neni zbatohen në të gjitha rastet, përveçse kur me akte të tjera, ligjore e nënligjore, përcaktohet ndryshe.

6.6 NENI 33 - Banesat familjare në territorin rural

1. Në rastin e zhvillimit të strukturave individuale, zhvilluesi merr përsipër ndërtimin me shpenzimet e veta të të gjithë infrastrukturës inxhinierike dhe teknike të nevojshme për shfrytëzimin e territorit rural për banim.

2. Në të gjitha rastet e kërkesave të zhvillimit për banim në territorin rural, në të cilin nuk është zhvilluar infrastruktura inxhinierike, sipas parashikimeve të këtij neni dhe kesaj rregullore zhvillimi, struktura e propozuar do të parashikojë realizimin e infrastrukturës septike sipas standardeve teknike.

3. Për të gjitha lejet e ndërtimit të lejuara sipas përcaktimeve të këtij neni, rendi dhe grafiku i punimeve ndërtimore do të kërkohet të parashikojë realizimin e infrastrukturës inxhinierike për furnizimin me ujë dhe depozitimet septike, sipas standardeve të përcaktuara nga ky nen dhe kjo rregullore zhvillimi, përpara fillimit të punimeve ndërtimore për zhvillimin e strukturës së banimit. Vetëm pas kontrollit nga autoritetet e kontrollit të zhvillimit të territorit për implementimin e infrastrukturës inxhinierike, do të lejohet fillimi i punimeve ndërtimore për strukturat e banimit.

4. Përcaktimet e të gjitha pikave të këtij neni, vlejnë dhe për të gjitha kategoritë e përdorimeve të tjera.

6.7 NENI 34 - Komplekset mikse në territorin rural

1. Komplekse mikse janë ato zhvillime të cilat përfshijnë zhvillimin e njëkohshëm të më shumë se 4 banesave një-familjare apo të më shumë se një tipologjie përdorimi të tokës dhe strukturave në të dhe që përmbushin kushtet e përcaktuara në Nenin 23, Kreu V, të kësaj rregullore zhvillimi.

2. Për miratimin e tipologjive të kompleksève të banimit dhe shërbimeve në territor apo njësi-strukturore, autoritetet vendore do procedojnë me Leje Ndërtimi vetëm pas miratimit të Lejes të Zhvillimit, e cili do të definojë teknikisht dhe grafikisht të gjitha mënyrat e ndërhyrjes në territor, grafikun e punimeve në rend kategorie ndërhyrje në territor, duke prioritizuar realizimin e infrastrukturës inxhinierike dhe septike sipas standardeve teknike në fuqi.

3. Në rastet kur zhvillimet komplekse prekin njëkohësisht territoret gjeografike të dy apo më shumë njësive strukturore, në një sipërfaqe totale që nuk i kalon 30% të sipërfaqes totale të këtyre njësive strukturore të prekura nga strategjia e zhvillimit, kërkesa për zhvillim do të shoqërohet me aplikimin për miratimin e Lejes të Zhvillimit e cila do të paracaktojë kushtet e zhvillimit në aplikimin për Leje Ndërtimi.

4. Në rastet kur Leja e Zhvillimit prek pjesë të territorit të studiuar nga PDV, atëhere Leja e Zhvillimit mund të jetë dhe ekstrakt i kushteve të zhvillimit të miratuara në PDV.

6.8 NENI 35 - Koeficienti i shfrytëzimit të territorit (Ksht)

1. Koeficienti i shfrytëzimit të tokës (Ksht) për ndërtim është raporti ndërmjet sipërfaqes së gjurmës së strukturës të vendosur në parcelë/grup-parcelash me sipërfaqen e pjesës të parcelës/grup-parcelave të përfshira në përdorimin përkatës.

Në rastet kur parcela shtrihet në dy apo më shumë përdorime, KSHT matet për secilin përdorim më vete.

2. Gjurma e strukturës matet nga vendosja e planit të katit përdhe në parcelë/grup parcelash.

3. KSHT-ja matet në përqindje (%).

4. KSHT-ja maksimale për kategoritë banim për njësitë strukturore pjesë të zonave urbane lejohet deri në masën 40%, ndërsa për njësitë strukturore pjesë të zonave rurale në respektim të përcaktimeve të pasaportës.

5. KSHT-ja maksimale e lejuar për të gjitha kategoritë në territor, pjesë të zonave urbane, lejohet deri në masën 45%. Për territorin rural kushtëzohet të jetë deri në masën 25%.

6. Përtej parashikimeve të pikave 4 dhe 5 të këtij neni, KSHT-ja maksimale e lejuar për kategorinë e përdorimeve për struktura dhe territore industriale dhe ekonomike është 70%.

7. Në të gjitha rastet dhe tipologjitë e ndërhyrjeve mikse në territor, KSHT do të matet sipas përdorimeve. Në rastet kur ndërthurjet bëhen në lartësi, KSHT do të zbatohet sipas përkufizimeve për kategorinë e përdorimit të vendosur në katin përdhe. Në rastet kur ndërthurjet e përdorimeve bëhen në plan, atëherë KSHT do të llogaritet për të gjitha përdorimet bashkërisht, me kushtin e respektimit të kufizimit maksimal të shfrytëzimit të territorit, sipas përcaktimeve të pikave 4 dhe 13 të këtij neni.

8. Për të gjitha tipologjitë e tjera të ndërhyrjes në territor dhe mënyrat e përdorimit të tokës, KSHT-ja do të përcaktohet në kodet e zonimit të tokës dhe kushtet e zhvillimit të njësive strukturore, përveç parashikimeve të pikës 4 të këtij neni.

9. Nuk konsiderohen gjurmë strukture dhe nuk përfshihen në përllogaritjen e KSHT-së vetëm ato raste të arkadave gjatësore të cilat kanë një gjerësi minimale prej 3 metrash përgjatë të gjithë gjatësisë të strukturës dhe vetëm ato raste tunelesh të cilat kanë një gjerësi minimale prej 6 metrash dhe lartësi minimale prej 8 metrash për shfrytëzim publik.

10. Nuk konsiderohen gjurmë ndërtimi dhe nuk përllogariten në KSHT për ndërtim strukturat e përkohshme apo sipërfaqet e shfrytëzuara për rekreacion si pishina, shatërvane, pista hipizmi, etj, me përdorim publik apo privat, me kushtin që këto të fundit të jenë të hapura. Në rastin kur mjediset rekreative të përherëshme parashikohen të mbyllura, do të konsiderohen struktura dhe do të përfshihen në parashikimet e përcaktuara nga kjo rregullore dhe legjislacioni në fuqi.

11. Përjashtim nga pika 4 dhe 5 të këtij neni bëjnë vetëm rastet e rizhvillimit të

pallateve shumëfamiljare, dy kate e më shumë, ku transformimi urban kushtëzohet nga shfrytëzimi i gjurmëve ekzistuese të godinave. Në këto raste, KSHT-ja mund të maksimalizohet deri në zëvendësim të plotë të gjurmëve të godinave ekzistuese, me kushtin e ruajtjes se siluetës së unifikuar të rrugëve në drejtim të vijave të ndërtimit.

12. Ksht-ja e lejuar për çdo njësi strukturore, për çdo lloj përdorimi, përcaktohet duke respektuar:

    a. vlerat mjedisore dhe ekologjike në njësi;

    b. vlerat e trashëgimisë kulturore në njësi;

    c. diellëzimin dhe orientimin;

    d. nevojën e krijimit të hapësirave publike.

6.9 NENI 36 - Koeficienti i shfrytëzimit të territorit për rrugë

1. Koeficienti i shfrytëzimit të parcelave për rrugë dhe zona të shtruara (KSHR) është raporti midis sipërfaqes së gjurmës në tokë të këtyre të fundit dhe sipërfaqes territoriale bruto të njësisë strukturore.

2. KSHR-ja matet në përqindje (%).

3. Përqindja e rekomanduar e KSHR-së për njësinë strukturore është minimalisht 10%.

6.10 NENI 37 - Koeficienti i shfrytëzimit të territorit për hapësira publike

1. Koeficienti i shfrytëzimit të parcelave për hapësira publike (KSHP) është raporti midis sipërfaqes së gjurmës në tokë të këtyre të fundit dhe sipërfaqes territoriale bruto të njësisë strukturore.

2. KSHP-ja matet në përqindje (%). Përqindja minimale e KSHP-së e rekomanduar për njësinë strukturore duhet të jetë 40%.

3. Për njësitë strukturore të cilat zhvillohen me anë të PDV-së duke parashikuar mbrojtjen e më shumë se 60% të ndërtimeve ekzistuese të zonës, koeficienti i shfrytëzimit të territorit për hapësira publike, në mënyrë përjashtimore mund të zvogëlohet deri në 20%.

4. Çdo tipologji ndërhyrje në territor, në respektim të këtij neni, duhet të sigurojë zhvillimin gjelbërimit filtrues për sipërfaqe minimale prej 10% të sipërfaqes të parcelës apo grup-parcelave të përfshira në ndërtim, si pjesë përbërëse e territorit në

funksion të KSHP-së.

6.11 NENI 38 - Intesiteti i ndërtimit

1. Intensiteti i ndërtimit (I) për një njësi strukturore jepet në vlerë numerike dhe shpreh sipërfaqen maksimale të ndërtimit për një njësi strukturore.

2. Intensiteti i ndërtimit (I) në Planin e Përgjithshëm Vendor, jepet në nivel bruto vetëm për ato njësi strukturore që janë objekt hartimi i Planeve të Detajuara Vendore dhe është i barabartë me raportin e sipërfaqes së përgjithshme të pritshme të ndërtimit (shumën e metrave katrorë total ndërtim i pritshëm) për të gjitha kategoritë për një njësi strukturore / sipërfaqen totale të njësisë, pavarësisht përkatësisë pronësore të secilës parcelë, të llogaritur deri në akse të rrugëve të propozuara apo kufirin e njësive strukturore të përcaktuara nga PPV.

3. Rregullimi i raportit të intensitetit (I) nga Bruto në Neto, do të bëhet nëpërmjet analizës së territorit nga Planet e Detajuara Vendore, të cilat do të shprehin grafikisht dhe numerikisht diferencën mes sasisë së parashikuar totale për zhvillim për të gjithë njësinë strukturore dhe asaj të ndërtuar (situatë e formuar definitivisht). Diferenca do të shpërndahet në vijim në mënyrë proporcionale duke përcaktuar saktësisht sasinë volumore të pritshme për zhvillim për parcelat apo grup-parcelat e secilës zonë zhvillimi.

4. Shpërndarja e parametrave të zhvillimit për të gjitha zonat e zhvillimit, subjekt i hartimit të PDV-ve, gjatë analizës së mënyrës së ndërhyrjes në territor, do të jetë proporcionale për të gjitha zonat e zhvillimit.

5. Për të gjitha njësitë strukturore të cilat nuk janë subjekt i hartimit të Planeve të Detajuara Vendore sipas përcaktimeve të këtij Plani të Përgjithshëm Vendor dhe kësaj Rregullore të Zhvillimit, intensiteti (I) për njësinë strukturore jepet në marrdhënie të drejtpërdrejtë me të gjitha parcelat apo grup-parcelat e njësisë strukturore dhe është i njëjtë si për njësinë ashtu dhe për çdo parcelë brenda territorit të njësisë strukturore. Në respektim të përcaktimeve të kësaj pike, për ato parcela që shtrihen në përdorime të ndryshme, intensiteti (I) llogaritet më vete për secilën pjesë parcele të përfshirë në secilin përdorim dhe përdoret sipas përdorimeve përkatëse, ose llogaritet sipas kushteve dhe raporteve të përcaktuara në pasaportë për secilin përdorim.

6. Parcelat të cilat shtrihen në dy njësi strukturore do të gjykohen rast pas rasti, duke prioritizuar mundësimin e menaxhimit të vlerave të zhvillimit të një parcele brenda një njësie strukturore gjatë hartimit të PDV-ve apo zhvillimit. Në rastet kur njësitë kufitare kanë vlera, përdorime apo mundësi të ndryshme zhvillimi, atëherë do të gjykohet sipas rastit duke përfshirë parcelen për zhvillim në njësinë strukturore me

mundësi më të madhe zhvillimi nëse:

a. Përfshirja e të gjithë parcelës në zhvillim ndihmon për realizimin e interesit publik;

b. parcela ka mbi 60% të sipërfaqes së saj brenda njësisë strukturore me hierarki zhvillimi më të lartë; apo

c. zona zhvillimore e njësisë kufitare ku shtrihet parcela paraqitet e zhvilluar.

Për të gjitha rastet e tjera, parcela do të parashikohet me mundësi të ndryshme zhvillimi, sipas kufirit të njësive strukturore apo përdorimeve. Në vijim, intensiteti i ndërtimit do të matet për secilën pjesë parcele në secilin përdorim në të cilën shtrihet.

Në respektim të kësaj pike, në rastet e përfshirjes në menaxhim të parcelave të cilat shtrihen përtej kufirit të njësisë strukturore gjatë procesit të hartimit të PDV, atëherë automatikisht PDV mbart detyrimin e ripërkufizimit të njësisë strukturore sipas kufirit të parcelave të përfshira në zhvillim, subjekt i planit të detajuar vendor.

7. Intensiteti i ndërtimit (I) për çdo tipologji njësie strukturore do të përcaktohet në kodet e zonimit të tokës dhe kushtet e zhvillimit të njësive strukturore, pjesë të Kreu t 10, të kësaj rregullore.

6.12 NENI 39 - Distancat

1. Treguesit bazë të përcaktuar nga kjo rregullore janë të detyrueshëm për t'u zbatuar nga projektuesit gjatë hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit.

2. Distancat sipas këtij neni duhet të jenë të tilla që të mos cenojnë lirinë e përdorimit të pronës, të krijojnë hapësira publike dhe/ose funksionale të nevojshme për shërbimet ndaj komunitetit dhe të garantojnë siguri individuale dhe shëndetësore.

3. Distancat e përcaktuara në këtë rregullore janë: distancat midis ndërtimeve; distancat midis ndërtimit dhe kufirit të parcelës/pronës; distancat midis ndërtimit dhe kufirit të trupit të rrugës;

4. Përcaktimi i distancave bëhet nga autoriteti i planifikimit sipas përcaktimeve në këtë rregullore, dhe në PDV, në përputhje me këtë nen, për sa kohë që nuk parashikohet ndryshe në legjislacionin e posaçëm sektorial në fuqi.

5. Për përcaktimin e distancave vlerësohen: orientimi dhe diellzimi, gjendja e ndërtimeve kufitare, standarddet higjieno-sanitare, mjedisore dhe të sigurisë sipas legjislacionit të posaçëm.

6. Për përcaktimin e distancave ndërtesë-ndërtesë, ndërtesë-rrugë dhe ndërtesë-kufij prone, në projektim, do të zbatohen normat minimale të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, me përjashtim të rasteve kur PDV propozon distanca të tjera më ta mëdha se minimumi i parashikuar.

7. Në zonat e konservimit apo ristrukturimit, që nuk janë subjekt për hartimin e PDV-ve, në rastet e nevojës së rindërtimit të banesave të vjetra dhe të papërshtatshme për të jetuar në parcelën ekzistuese, do të ruhen distancat e ndërtesës ekzistuese edhe për ndërtimin e ri, me kusht që të mos ndryshojë koeficienti i shfrytëzimit të truallit dhe intensiteti i ndërtimit ekzistues.

8. Për arsye të zhvillimit të parashikuar nga PPV-ja për një zonë urbane të konsoliduar, ku do të aplikohet konsolidimi urban ose rizhvillimi, veçanërisht në kushtet e zbatimit të instrumenteve financiare të drejtimit të zhvillimit, të aplikuara nëpërmjet hartimit të planit të detajuar vendor apo kur diktohet nga nevoja për krijim të hapësirës publike kompakte, në një zonë urbane me zhvillim intensiv, distanca e objektit/ ndërtesës nga rruga duhet të respektojë vijën e ndërtimit ekzistuese të formuar. Në këto raste kjo distancë mund të jetë edhe 0 metër nga kufiri i pronës/parcelës.

9. Në rastet e zhvillimit pa PDV, gjatë proçesit të konsolidimit urban, nëse pronari i një ndërtese ekzistuese të ulët, shpreh interesin për të zhvilluar pronën e tij, ndërkohë që strukturat kufitare me parcelën kur kërkohet zhvillimi, të ndërtuara para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, nuk kanë respektuar të gjitha kushtet e distancave (ndërtesë-ndërtesë, ndërtesë-kufi prone, ndërtesë-rrugë) të legjislacionit përkatës në kohën kur është kryer ndërtimi, atëherë pronarit të ndërtesës ekzistuese që ka interes, i lind e drejta të zhvillojë/ndërtojë, duke ruajtur vetëm distancat nga kufiri i pronës përkatëse dhe/ose nga rruga duke respektuar vijën e ndërtimit të formuar.

10. Në rastet kur përdoret gropë septike dhe pus individual për furnizimin me ujë, në çdo zonë banimi, distanca mes të dyjave do të jetë minimalisht 15 m.

6.13 NENI 40 - Vija e ndërtimit

1. Vija e ndërtimit është kufiri maksimal i lejuar për vendosjen e një strukture në lidhje me trupin e rrugës ose kufirin e zonës zhvillimore apo njësisë që i referohet, referuar kushteve ligjore të përcaktuara në Kodin Rrugor apo vijave të ndërtimit ekzistuese të përcaktuara nga situata e formuar në terren apo analiza mbi terrenin nga studimi i rrjetit rrugor apo planet e detajuara vendore.

2. Vija e ndërtimit përcakton pozicionimin e faqes të një strukture në raport me kufirin e trupit të rrugës ekzistuese apo të propozuar.

3. Faqe e strukturës nënkupton trupin e përgjithshëm të strukturës dhe jo elementët pjesor volumetrik si konsolat e ballkoneve, etj, me kushtin që këto të fundit të mos tejkalojnë 50% të sipërfaqes totale të një faqe fasade.

4. Nuk lejohet që konsolat të tejkalojnë vijën e ndërtimit në lartësi më të ulët se 5 metra nga kuota e trotuarit dhe 1.5 metra nga faqja e strukturës.

5. Në rastet kur planet e sistemimit dhe të vendosjes të katit përdhe parashikojnë nevojën e vendosjes së shkallëve dhe rampave për akses, nuk lejohet që pozicionimi i tyre të tejkalojë vijën e ndërtimit.

6. Në çdo rast, volumetria e strukturës duhet të jetë brenda kufijve të parcelës apo grup-parcelave të pronave të përfshira në zhvillim.

6.14 NENI 41 - Lartësia e strukturave

1. Përcaktimi i lartësisë maksimale të lejuar për efekt planifikimi për çdo njësi, të shprehur në numër katesh dhe në metra, bëhet në pasaportat përkatëse të njësive strukturore duke respektuar:

   a. lartësinë e strukturave ekzistuese përreth strukturës së re të propozuar;

   b. normat e lejuara të distancave;

   c. vlerat mjedisore dhe ekologjike në njësi;

   d. vlerat e trashëgimisë kulturore në njësi;

   e. diellëzimin dhe orientimin;

   f. respektimin dhe harmonizimin e siluetës ekzistuese me atë të propozuar;

   g. respektimin e normave mjedisore.

2. Në respektim të kushteve të zhvillimit, lartësisë të numrit të kateve dhe rregullave të përcaktuara nga kjo rregullore si dhe kuadri ligjor në fuqi, nocioni i katit nënkuptohet si vijon:

   a. Kat i plotë nënkupton ndërtimin e mbi 50% të sipërfaqes totale të katit

   b. Gjysëm kati, nënkupton ndërtimin e 30% - 50% të sipërfaqes totale të katit

   c. Papafingo, nënkupton ndërtimin e më pak se 30% të sipërfaqes totale të katit

3. Në rastet kur lartësia e strukturës shprehet në metra, lartësia e çdo kati me përdorim banim apo shërbime, llogaritet sipas përcaktimeve të lartësisë minimale

nga rregulloret e zhvillmit në fuqi. Në rastet e strukturave të shërbimit, qëndrave komerciale apo kullave të biznesit, lartësia e katit do të përllogaritet nga përcaktimet e PDV-së apo dokumentit të Lejes të Zhvillimit sipas rastit, duke e arsyetuar teknikisht nëpërmjet prezantimit të projekt idesë të zhvillimit dhe vetëm lartësia e shprehur në kate është detyruese.

4. Zhvillimet e strukturave, në varësi të kategorive të zonimit, ndahen në:

   a. Zhvillim i strukturave të ulta (deri në 3k);

   b. Zhvillim i strukturave të mesme (3 – 6 k);

   c. Zhvillim i strukturave të larta (mbi 6 k).

5. Strukturat mbi tarracë e çati, si: oxhaqet, tubat, pajisjet e ashensorëve, panele diellore dhe elemente të tjera të ngjashme, nuk llogariten në lartësinë e strukturave.

6.15 NENI 42 - Ristrukturimi i strukturave ekzistuese

1. Proçesi i ristrukturimit të strukturave ekzistuese përfshin veprimet e ndërhyrjes për rivlerësimin apo rindërtimin e strukturave ekzistuese.

2. Proçesi i ristrukturimit lejohet pa nevojën e hartimit të planit të detajuar vendor, pavarësisht përcaktimeve të njësisë strukturore, me përjashtim të punimeve që parashikojnë shembje dhe rindërtim të strukturave.

3. Në rastet kur ristrukturimi i strukturës ekzistuese parashikon zhvillimin apo shtimin pjesor volumetrik anësore apo në lartësi të strukturave ekzistuese në territor, sipas përcaktimeve të PDV-së, propozimi do të shoqërohet gjatë aplikimit për Leje Zhvillimi, me vendosjen e strukturës të propozuar për shtim apo plotësim të volumetrisë ekzistuese në raport me volumetrinë urbane ekzistuese, duke pasqyruar në plan dhe volumetri impaktin urban të propozimit sipas kushteve ligjore të distancave apo shfrytëzimit të territorit në fuqi.

4. Ristrukturimi përfshin edhe proçesin e rindërtimit, për ato raste të ndërtesave të degraduara strukturalisht apo që përbëjnë rrezik për banorët e ndërtesave, për të cilat lejohet proçesi i shembjes dhe rindërtimit edhe në zonat e konservimit, me kushtin e respektimit të gjurmës dhe kushteve urbanistike të strukturës origjinale. Në rastin e rindërtimit apo ristrukturimit të një strukture monument kulture apo pjesë të një ansambli kulturor, çdo ndërhyrje do të lejohet vetëm pas miratimit të organeve kompetente për monumentet e kulturës, sipas ligjit për monumentet e kulturës në fuqi.

5. Në të gjitha rastet kur ndërhyrjet për ristrukturim parashtrojnë dhe nevojën e shtesës volumetrike, kjo e fundit do të lejohet vetëm në respektim të kushteve ligjore të bashkëpronësisë sipas parashikimeve të përcaktuara në Kodin Civil në fuqi me miratimin e jo më pak se ¾ të bashkëpronarëve të ndërtesës, apo në vlerësim të kushteve teknike të strukturës dhe kushteve arkitektonike, të cilat e lejojnë ndërhyrjen.

6. Në të gjitha strukturat buzë rrugëve kryesore dhe dytësore, shtesat lejohen vetëm për ndërhyrje nga autoritetet vendore, në respektim të politikave të zhvillimit për interes publik, për stimulimin e ristrukturimit të arkitekturës urbane dhe rigjenerimit peizazhik të rrugëve kryesore dhe dytësore të qytetit.

7. Gjatë proçesit të ristrukturimit, lejohen mbylljet e plota apo të pjesëshme të verandave apo terracave të shfrytëzueshme për shfrytëzim individual, në rastin kur këto gëzojnë titullin e pronësisë, me kushtin e respektimit të distancave të ndriçimit apo në rastet kur ndërhyrja nuk cënon arkitekturën peizazhike të bllokut. Në të kundërt, në rastin e bashkëpronësisë, çdo ndërhyrje do të lejohet në respektim të pikës 5 të këtij neni, dhe kushteve ligjore në fuqi.

8. Në rastet kur ristrukturimi parashikon mbylljet e plota apo të pjesëshme të verandave apo terracave të shfrytëzueshme për shfrytëzim individual, apo në rastet kur parashikohet mbyllja e ballkoneve, kërkesa do të shoqërohet me projekt-idenë e zhvillimit e cila përcakton kushtet dhe mënyrën e ndikimit në fasadën origjinale të strukturës. Autoritetet vendore të planifikimit do të gjykojnë rast pas rasti duke prioritizuar ruajtjen dhe unifikimin e ndërhyrjes në fasadë dhe arkitekturë. Vendimmarrja mund të kushtëzojë dhe ndërhyrje vetëm në ato raste kur ristrukturimi prek të gjithë fasadën e strukturës.

9. Proçesi i ristrukturimit, mënyrat e ndërhyrjes së rivlerësimit dhe proçesi i miratimit rregullohen sipas rregulloreve të zhvillimit dhe ligjit të planifikimit në fuqi, nëpërmjet autorizimit apo aplikimit për Leje Zhvillimi në varësi të tipologjisë të ndërhyrjes në strukturë.

6.16 NENI 43 - Vazhdimësia e faqeve kallkan

1. Në të gjitha ato territore të mundshme për zhvillim, që ballafaqohen me struktura ekzistuese me faqe kallkan, për të kryer mbylljen e zhvillimit (duke qënë se kallkani ka krijuar konceptin e vazhdimësisë në terren të situatës urbane) lejohen të drejta zhvillimi sipas parametrave të parashikuara nga kjo rregullore dhe ky plan. Këto të drejta përfshijnë mundësinë e zhvillimit sipas rasteve përjashtimore për stimulimin e një lloji të caktuar zhvillimi, sipas kushteve të përcaktuara në Nenin 52 të kësaj

rregullore zhvillimi.

2. Zhvillimi për mbylljen e faqeve kallkan sipas pikës 1 të këtij neni, lejohen vetëm me kushtin që:

   a. Në zonat rurale, struktura e re e paraqitur nga kërkuesi, në rast se nuk është parashikuar ndryshe në PDV, gjatë aplikimit për leje zhvillimi të mos ketë vijuese një faqe të re kallkan për një zhvillim të ri vijues (por të vijë në kallkan vetëm me faqen e objektit ekzistues kallkan-për të mbyllur situatën e formuar-dhe në faqet/ drejtimet e tjera-me faqe me distanca/dritare);

   b. Propozimi për zhvillim i paraqitur nga kërkuesi nuk bie ndesh apo cënon zhvillimin e veprave me interes publik të nën-njësisë, si rrjetin rrugor, ndërtim facilitetesh publike si çerdhe, kopshte, shkolla (sipas parashikimeve të PPV).

   c. Propozimi për zhvillim i paraqitur nga kërkuesi nuk duhet të cënojë hapësirat e hapura, por të krijojë mundësi zhvillimi vetëm në ato territore ku sot ka aktualisht të ndërtuara banesa të ulta;

   d. Zhvillimi i propozuar në këto njësi strukturore të respektojë karakterin urban të njësisë.

   e. Parametrat urbanë të këtyre rasteve do të gjykohen/shqyrtohen individualisht rast mbas rasti mbi përputhshmërinë me situatën urbane dhe parashikimet e Planit, nga autoritetet vendore, të cilat mund të miratojnë dhe/ose refuzojnë në mënyrë të arsyetuar kërkesën.

3. Gjatë hartimit të PDV-ve apo paraqitjes të kërkesave të reja për zhvillim, lejohet që zhvillimi i propozuar të përfundojë me një faqe të re kallkan, kur kjo e fundit është e domosdoshme për vijimësinë e zhvillimit.

4. Nuk lejohet distancim i strukturave nga kufiri i pronës pavarësisht se ruhen distancat nga kufiri i pronës apo nga strukturat ekzistuese, në rastet kur zhvillimi i ri i propozuar nuk lejon mundësitë e zhvillimit me të njëjtat parametra për parcelat kufitare. Në këto raste autoritetet vendore duhet të sigurojnë vazhdimësinë e mundësisë së zhvillimit në perspektivë për parcelat kufitare nëpërmjet realizimit të zhvillimit me faqe kallkan sipas kushteve ligjore në fuqi.

6.17 NENI 44 - Parkimet

1. Çdo zhvillim duhet të sigurojë numrin e parkimeve për banorët dhe në raste të caktuara, për vizitorët dhe përdoruesit. Numri i parkimeve për banorët duhet të sigurohet brenda sipërfaqes së përgjithshme të parcelës apo grup-parcelave për

zhvillim, mbi ose nëntokë.

2. Nga përcaktimet e pikës 1 të këtij neni mund të bëhet përjashtim, kur brenda njësisë ka parkime publike për tu ndërtuar sipas përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm dhe kësaj rregulloreje nga organe publike ose subjekte private të cilat plotësojnë nevojat për parkim të banorëve të njësisë.

3. Në rastet kur për realizimin e parkimeve nevojitet shtrirja e tyre mbi tokë dhe ndërthurja e sipërfaqeve të parkimeve me sipërfaqet e gjelbra, atëhere zgjidhja duhet të jetë me pllaka të gjelbra dhe parkimet duhet të përkufizohen me gjelbërim të mesëm dhe të lartë hijëzues.

4. Në këto raste, raporti i vend-parkimeve të parashikuara nëntokë me ato të parashikuara mbi tokë nuk lejohet të tej-kalojë masën 70% nëntokë me 30% mbi tokë.

5. Sigurimi i parkimeve përgjatë rrugëve, me qëllim që objektet/zhvillimet private të plotësojnë parametrat e kërkuara të parkimeve nuk është një përgjegjësi e detyreshme e organeve publike.

6. Numri i parkimeve që duhet të sigurohet për çdo objekt, është i lidhur me menaxhimin e trafikut dhe lëvizshmërinë. Mbështetur në studimet për transportin, duhet të mbahen në konsideratë këto normativa:

   a. Banim - minimalisht 1 vend parkimi/apartament;

   b. Hotel – minimalisht 1 vend parkimi për çdo 3 dhoma (në këto raste projekti duhet ti përshtatet normativave ndërkombëtare për përcaktimin e cilësisë të shërbimit dhe kualifikimit të hotelit sipas standardeve të projektimit dhe planifikimit të shërbimeve në projekt;

   c. Aktivitet tregtar - brenda qendrës: 1 vend parkimi për 100m^2;

   d. Nën-njësi strukturore tregtare periferike - 2 vende parkimi për 100m^2;

   e. Shërbime dhe facilitete - 1 vend parkimi për 100 m2 sipërfaqe

   f. Shkolla dhe edukim - 1 vend parkimi për çdo klasë;

   g. Sipërfaqja minimale bruto e parkimit për makina private është 25m2

   h. Në njësi strukturore të kategorisë Banim, për çdo zhvillim të parashikohet të paktën një vend parkimi për çdo njësi banimi, në respektim të pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

9. Numri i parkimeve në objektet shumë funksionale mund të variojë në varësi të përqindjes së funksioneve.

10. Në të gjitha rastet, hyrja në parkimet nëntokësore duhet të sigurohet nëpërmjet rampës. Në rastet kur zhvilluesi propozon hyrje në parkim nëpërmjet ashensorit, kjo do të jetë suplementare e rampës.

11. Këto kërkesa mund të rishikohen, gjatë hartimit të PDV-ve, në varësi të politikave të transportit që synojnë të ulin kërkesën për parkim në qendër në lidhje me një akses të mirë të transportit publik dhe rritjen e nevojave për parkim në periferi.

12. Parkimet nëntokësore dhe strukturat e dedikuara për parkim publik, sipas pozicioneve të identifikuara në territor në PPV, do të trajtohen me studim të veçantë nga autoritetet vendore.

6.18 NENI 45 - Varrezat

1. Varrezat duhet të jenë të izoluara nga zonat e banimit nëpërmjet brezit të rezervuar. Ndalohen ndërtime të reja apo të zgjerohen ato ekzistuese brenda brezit të rezervuar prej 300 metra.

2. Këshilli i Bashkisë Tropojë, ka të drejtë të vendosë për ndryshimin e gjerësisë të brezit të rezervuar.

3. Varreza private mund të ngrihen nga subjekte private mbi troje në pronësi të tyre. Ngritja e varrezave private do të bëhet me miratim të Këshillit të Bashkisë. Kriteret dhe procedurat për ngritjen e varrezave private përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

7 SISTEMI I MOBILITETIT

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGENCIA KOMBETARE E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT
TIRANE
SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGENCIA E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT
TIRANE
SEKRETARIA


Kufi shtetëror
Kufi administrativ bashkiak
Kufi njësi administrative
Izolipse
Park kombëtar "Alpet e Shqipërisë"
Rezervë Strikte Natyrore Lumi I Gashit (kategoria I-rë IUCN /Pasuri UNESCO)
Park Kombëtar Lugina e Valbones (kategoria e II-të IUCN)
Park rajonal "Nikaj-Mërtur"
C-Rrugë interurbane dyfësore
C-Rrugë interurbane dyfësore e propozuar
E-Rrugë urbane dyfësore
E-Rrugë urbane dyfësore e propozuar
F-Rrugë lokale
F-Rrugë lokale e propozuar
Transport ujor
Transport ujor i propozuar
Sistemi urban
Infrastruktura interesi vendor
Qendër intermodale kryesore
Stacion autobusi
Stacion autobusi i propozuar
Ndalesë tragetë
Ndalesë tragetë e propozuar

7.1 NENI 46 - Infrastruktura

Koncepti i rrjetit rrugor

Koncepti i rrjetit rrugor në planin e përgjithshëm vendor bazohet në dy shtylla kryesore:

- Rrjeti Rrugor ekzistues i klasifikuar në përputhje me shpërndarjen e lëvizjes
- Rrjeti Rrugor i ri i cili do të ndërtohet si në zonat ekzistuese të urbanizuara po ashtu dhe shtrirjet dhe zgjerimet e planifikuara së bashku me klasifikimin

Rrjeti ekzistues rrugor në Tropojë për shkak të fluksit jo shumë të lartë të trafikut është kryesisht i mjaftueshëm për sa i përket intensitetit të rrjetit, kjo dhe për shkak të investimeve të kryera ndër vite, por duke marrë në konsideratë rritjen e numrit të turistëve, zgjerimi dhe përmirësimet e rrugëve janë të nevojshme. Zgjerimi i rrjetit rrugor mbetet prioritet për qytetin e Bajram Currit dhe përbën kusht të rëndësishëm për rritjen e dendësisë së banesave dhe reduktimin e shtrirjes së pakontrolluar. Rritja e pritshme e turistëve që vizitojnë qytetin dhe zonat përreth tregon rritje të kërkesës për lëvizje, si rrjedhojë më shumë rrugë dhe zgjerime që mundëson aksesueshmëri më të lartë.

Rrjeti i ri rrugor i propozuar është konfiguruar në mëyrë të tillë që të plotësojë këto kërkesa. Njëkohësisht, është bërë edhe klasifikimi i tij, i cili lehtëson plotësimin e hallkave që mungojnë në rrjetin ekzitues. Plotësimi i sistemit rrugor me zgjatime dhe zgjerime është aspekti më kryesor në zhvillimin e sistemit rrugor në bashkinë e Tropojës dhe ky sistem është një nga pikat kyçe që përfshihet në të gjithë dokumentacionin rregullues mbi qytetin e Bajram Currit dhe bashkinë e Tropojës. Në Figurën 1 është treguar harta e rrjetit të ri të propozuar, i cili do të përballojë rritjen e pritshme të trafikut në të ardhmen. Përmirësimi i projektit në rrjetin e propozuar me planin e ri rregullues merr në konsideratë faktin se një strategji korrekte e zbatuar në bashkinë e Tropojës duhet të orientohet drejt mobilitetit të qëndrueshëm.

Rrjeti i propozuar përfshin konceptin e lëvizshmërisë së qëndrueshme që paraqitet në plan.

Planifikimi i rrejtit rrugor është bazuar në këto parime:

- Lëvizja (multimodale), e cila kufizon rritjen e fluksit të trafikut të mjeteve të motorizuara, zvogëlon ndikimin negativ të trafikut në mjedis dhe përmirëson cilësinë e mjedisit në zonat qendrore urbane
- Plotësimi i infrastrukturës rrugore dhe klasifikimi i tij, të cilat janë një masë efektive për strukturimin e zhvillimit urban hapësinor, si një element kryesor në konfigurimin e rrjetit për reduktimin e trafikut në zonat qendrore urbane.

Figura 1
Rrjeti rrugor i propozuar dhe klasifikimi i tij.

- Baza ligjore në të cilën mbështetet përcaktimi dhe kategorizimi i rrjetit rrugor është ligji Nr. 8378, date 22.7.1998 Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë (me ndryshimet), vendimi nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së shqipërisë", (me ndryshimet), si dhe të gjitha aktet e tjera të dala në zbatim të tyre.

Sipas karakteristikave të tyre konstruktive, teknike dhe funksionale rrugët klasifikohen si vijon:

- *Autostradë*
- *Rrugë Interurbane Kryesore*
- *Rrugë Interurbane Dytësore*
- *Rrugë Urbane Kryesore*
- *Rrugë Urbane Dytësore*
- *Rrugë Lokale*

Sa më sipër klasifikimi i rrugëve në Rrethin e Tropojës është:

B. *Rrugë Interurbane Kryesore:* Rrugë me karrexhata të pavarura ose të ndara nga trafikndarës të pakapercyeshëm, secila më të paktën dy korsi lëvizjeje dhe bankina të shtruara, pa kryqëzime në nivel, me hyrje të koordinuara për objekte anësore, e dallueshme nga sinjale të veçanta të fillimit dhe mbarimit, e rezervuar për qarkullimin e disa kategorive mjetesh me motor. Për të tjera kategori të mundshme mjetesh të përdoruesve duhet të parashikohen hapësira të përshtatshme. Për qëndrimin duhet të jenë parashikuar zona të caktuara, me hyrje e dalje, të pajisura përkatësisht me korsi ngadalësimi dhe shpejtimi.

C. *Rrugë Interurbane Dytësore:* Rrugë me një karrexhate me të paktën një korsi lëvizjeje për sens dhe bankina, me funksion kryesor lidhjen e Tropojës me rrjetin kombëtar kryesor.

Rrugët interurbane janë rrugët me funksione hyrëse dhe dalëse nga qyteti dhe në shërbim të transportit të këmbimit ndërmjet territorit urban dhe ekstra urban, si dhe të transportit tranzit përkundrejt zonave urbane. Në këtë kategori rrugësh, në të cilën hyjnë – për qytetet më të mëdha – autostradat urbane, pranohen elementët e transportit me lëvizjen e automjeteve të linjës dhe jo të linjës, duke përjashtuar në këtë rast automjetet që nuk mund të lëvizin me shpejtësi mbi 50 km/ore. (Në keto rrugë nuk lejohen vendparkimet, ndalesat e mjeteve publike, motocikletat dhe lëvizjet e këmbësorëve, me perjashtim të rasteve kur pajisen me korsi të vecanta përdorimi si pjesë e rrugës).

D. *Rrugë Urbane Kryesore:* Rrugë me karrexhata të pavarura, ose të ndara nga trafikndarës, secila me të paktën dy korsi lëvizjeje, bankina të shtruara dhe trotuare, me kryqëzime në nivel të pajisura me semafor ose rrethrrotullim. Për qëndrimin e mjeteve janë parashikuar zona ose breza anësore jashtë karrexhatës, të dyja me hyrje dhe dalje të përqëndruara. Rrugët urbane kryesore kanë si funksion shpëndarjen e trafikut që vjen nga rrugët lidhëse me rrjetin kombëtar në drejtim të rrugëve urbane dytësore

E. *Rrugë Urbane Dytësore:* Rrugë me një karrexhatë me të paktën dy korsi, bankina të shtruara dhe trotuare. Për qëndrimin janë parashikuar zona të pajisura me korsi manovrimi jashtë karrexhatës. Rrugët urbane dytësore kanë si funksion shpëndarjen e trafikut që vjen nga rrugët kryesore, zonat me funksione të ndryshme social-ekonomike dhe turistike.

Rrugët urbane,funksioni i të cilave është garantimi i fluiditetit të zhvendosjes të këmbimit të automjeteve edhe rrjetit të qarkullimit brenda qytetit po dhe të ndërlidhjes me rrugët interurbane. Ato lejojne një nivel të lartë të shërbimit të zhvendosjes në distanca më të mëdha brenda rrjetit urban. Në këtë kategori rrugësh bëjnë pjesë rrugët e shpejta urbane, rrugët me shpejtësi të kufizuar urbane, itineraret e rezervuara të mjeteve publike të krijuara në korsitë e rrugëve të rezervuara. Në rrugët urbane kryesore me korsi jo të rezervuara, janë të lejuara të gjithë komponentet e Transportit si dhe sipas përkufizimit edhe perjashtimi i qendrimeve të automjeteve aty ku rruga duhet të jetë rrjedhëse kryesore.

F. *Rrugë Lokale:* Rrugë urbane ose interurbane, e sistemuar në mënyrë të përshtatshme por që nuk bën pjesë në rrugët e mësipërme. Rrugë lokale janë të gjitha rrugët e tjera me kapacitet të ulët dhe që bëjnë lidhjet midis njësive funksionale dhe për shkak të shpejtësisë së ulët mund të përdoren nga mjetet, këmbësorët dhe bicikletat.

Rrugët lokale kanë funksion lidhes ndërmjet lagjeve fqinjë (zhvendosje në distanca minimale, gjithmonë brenda qytetit) ose për zonat urbane me dimensione më të mëdha, ndërmjet pikave ekstreme të lagjeve. Në këtë kategori hyjnë, rrugët e destinuara për shërbimet kryesore urbane të lagjeve. Janë të pranueshme në këto rrugë të gjithë komponentet e Transportit, përfshi ketu dhe vendparkimet e automjeteve private. Rrugët lokale janë në shërbim direkt të zonës ku ndodhen. Në këtë kategori bëjnë pjesë rrugët për këmbësorë dhe rrugët per parkim; Klasifikimi funksional i sipërpërmendur i rrugëve nuk përjashton mundesinë që (atje ku shihet e nevojshme) të percaktohen itinerare specifike të rezevuara, të detyrueshme ose preferenciale, per kategori të vecanta të perdoruesve të mjeteve lëvizese dhe komponentet e tjere të transportit rrugor si: bicikleta, automjete ne shërbim të invalideve, automjete tregtare dhe automjete të urgjences dhe ndihmes të shpejte. Klasifikimi në fjalë nuk përjashton, përkundrazi kërkon, studimin

e ndërveprimit ndërmjet transportit rrugor dhe llojeve të tjera të transportit. Po kështu një vemendje e veçantë duhet ti kushtohet klasifikimit funksional të ndërveprimeve, me stacionet hekurudhore, aeroportet, portet dhe të transportit me teleferik etj.

Në bashkinë e Tropojës infrastruktura rrugore do të përbëhet nga rrugët e klasifikuara si më poshtë:

- *Rrugë interubane dytësore* *143 km*
- *Rrugë urbane kryesore* *6.4 km*
- *Rrugë lokale* *245 km*

Tipi i rrugës sipas Kodit Rrugor		Nënkategoria e rrugës
C	Interurbane Dytësore	C1 Unazë
E	Urban Dytësore	E1 Rrjedhëse Qendre
F	Lokale	L4 Rrugica

Tabela 1: Klasifikimi i rrugëve në nënkategori.

Tipi i rrugës	Karakteristikat gjeometrike dhe kufiri i shpejtësisë	Rregullimi qëndrimit, qarkullimi i Autobuzeve dhe korsitë e Bicikletave	Funksionet e lejueshme	Hyrjet anësore në funksion të rrugës kryesore
Urbane Dytësore Midis lagjeve	Te pakten një korsi për sensin e kalimit me karrexhata të ndara me kryqëzime në nivele, me semafor dhe me rrethrrotullime me diametër të jashtëm 30-50 m, kufiri i shpejtësise 40km/ orë	Lejohet parkimi me 45° në rastet e korsive të shërbimit 3.5m, nuk lejohet parkimi me 90°. Ndalesat e autobuzit të organizuara . Mundësi për korsi të rezervuara. Qarkullimi bicikletave i preferueshem me korsi më vete	Për zonat e shërbimit si kategoria më parë por pa korsi përshpejtimi/ ngadalësimi. Aktivitetet të tjera të lejuara vetëm në pranine e hapësirave të ndalesave të pershtatshme.	Mund të hapen duke shkëmbyer manovra majtas. Nuk jepen përshkrime të tjera.

Rrugë lokale Rrugica	Ndërhyrje si më sipër me reduktime në 15km/orë mund të jetë e përshtatur si ndërhyrje ndryshimi, pajisja e sensit unik e alternuar Kufiri i shpejtësisë në 30km/orë në zona të banueshme të ulura deri në 15km/orë, ku është parashikuar prioriteti I plote lëvizjeve dhe pedonaleve dhe në rrugët e parkimit	Parkim i lejueshëm pa korsi shërbimi dhe në 90° dhe në rrugët e parkimit Kalimi i transportit publik është i pa kështillueshëm por jo i ndaluar nëqoftëse po ndalesat jo të lejueshme. Kalimi në drejtim të gabuar në pergjithesi janë të lejueshme me ndërhyrje të ndryshimit të trafikut dhe vetëm me sinjalistikë vertikale . Kalimi i bicikletave është i lejuar me shpejtësi të reduktuar në pedonale.	Si kategoria mëparë. Eshtë e lejueshme përdorimi i hapësirave rrugore për aktivitete të ndryshme si dhe projekte specifike të riorganizimit dhe rikualifikimit të hapësirave publike	Jo e pranueshme

Tabela 2: Veçoritë e nënkategorive për zonat urbane (qytet).

7.2 NENI 47 - Struktura e rrjetit rrugor

Ndërtimi i rrugëve në të ardhmen si dhe i strukturave që lidhen me të për mënyrat alternative të lëvizjes është parashikuar si më poshtë:

Shpejtesia maksimale e projektuar (Km/orë)	Përmasa e korsisë (m)	Trafikndarësi i mesit (m)	Bankina ose kuneta (m)
Vmax ≤ 40	2.75 - 3.25	0.5 - 1	0.50 ÷ 0.75
40 < Vmax ≤ 60	3.25 - 3.50	0.5 - 1	1.00
60 < Vmax ≤ 80	3.50	- 2	1.25
80 < Vmax ≤ 100	3.50 - 3.75	- 3	1.50 – 1.75
Vmax > 100	3.75	-	3.00

Tabela 3: Elementet përbërës të projektimit të rrugëve.

Seksionet tërthore të rrugëve

Në Tabelën 4 tregohen profilet e rrugëve sipas kategorisë, ku është përcaktuar gjerësia e rrugëve që duhen ruajtur në kuadër të Planit Rregullues. Dimensionet e paraqitura në tabelë për seksionet që propozohen kanë të përfshirë një tolerancë, me qëllim lehtësimin e menaxhimit të hapësirës për të përballuar ngarkesën e ardhshme të trafikut apo kërkesat e sistemit të trasportit publik. Analiza dhe seksionet "tip" përfundimtare, të detyrueshme për zbatim, do të jepen nga projekti teknik i rrjetit rrugor. Deri në përfundimin e projektit teknik të skemës së rrjetit rrugor aplikohet seksioni maksimal i parashikuar nga plani, sipas kategorisë së rrugës.

Nr	Tipi i rruges KODI	Tipi i rruges nen Kategori	Lloji territorit	Kategoria e rruges	Numri i korsive per sens	Shpejtesia Intervali km/ora	Fluksi 1 korsi ne ore	Largesia e korsise	Largesia min.bank majtas	Largesia min.bank djathtas	Largesia minimale kors.emergjece	Korsi dedikuar Bus	Korsi dedikuar Bici	Parkim
1	Interurbane Dytesore	C1 Unaza 5	Interurbane	rruge kryesore	2 e me teper	60 - 100	950	3,75	0	1,50	0	jo	jo	jo
2	Urban Dytesore	E2 Lagjeje	Urbane	rruge dytesore	1 e me teper	40 - 60	600	3,00	0	0,50	0	jo	jo	po
3	Lokale	L4 Rrugica	Urbane	rruge lokale	1 e me teper	15 - 60	250	2,75	0	0,50	0	jo	jo	po

Tabela 4: Klasifikimi i rrugëve dhe seksionet tip me dimensionet sipas Kodit Rrugor.

Figura 2
Seksionet tip të rrugëve.



Figura 3
Seksionet tip të rrugëve.

7.3 NENI 48 - Përshkrimi i kryqëzimevev (ndërprerjeve) të rrugëve

Figura e mëposhtme ofron një panoramë të ndërprerjeve të rrugëve brenda rrjetit rrugor të propozuar. Tipologjia e kryqëzimeve (ndërprerjeve) ka si qëllim vetëm përcaktimin e hapësirave për t'u rezervuar, pra nuk përbën propozimin final për mënyrën e operimit të trafikut, gjë që duhet të përcaktohet në bazë të një studimi në nivel mikro-simulimesh për menaxhimin e trafikut.

Kryqëzimet e rrjetit rrugor përcaktohen duke ju referuar figurës në varësi të hierarkisë (Tipit të rrugës nga A në F) nga të cilat është e qartë që kemi dy lloje kryqëzimesh kryesore: në nivel dhe në disnivel. Ndërkohë për të gjitha kryqëzimet në nivel rast pas rasti duhet të studiohet mënyra e rregullimit të trafikut në varësi të flukseve përkatëse të trafikut, duke zgjedhur:

- *Rrethrrotullimet*
- *Rregullimin me semafor, apo*
- *Rregullimin me përparsi kalimi nëpërmjet shenjave të trafikut*

Më poshtë tregohet skema bazë e zgjidhjes:



- Legjenda: Lidhja e skemes me klasifikimin e rrjetit rrugor sipas **Kodit Rrugor**
- Kategoria **A** ne skeme – korespondon me kategorine **A** – Autostrade; me kategorine **B** – Interurbane Kryesore dhe me kategorine **D** – Urbane Kryesore
- Kategoria **B** ne skeme – korespondon me kategorine **B** – Interurbane Kryesore; me kategorine **D** – Urbane Kryesore
- Kategoria **C** ne skeme – korespondon me kategorine **C** – Interurbane Dytesore; me kategorine **E** – Urbane Dytesore
- Kategoria **D** ne skeme – korespondon me kategorine **E** – Urbane Dytesore ; me kategorine **F** – Lokale
- Kategoria **E** ne skeme – korespondon me kategorine **F** – Lokale

Figura 4
Klasifikimi i kryqëzimeve.

Ndërtimi i kryqëzimeve të reja të rrjetit rrugor në nivel si dhe rikualifikimi i tyre, duhet të bazohet në kritere projektuese të standardit dhe Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 628, datë 15.7.2015, Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve.

Kryqëzimet në nivel karakterizohen nga rreze të ndryshme kthimi të formuara nga drejtime që kryqëzohen me kënde të ndryshme nga ky rrjet që i kundërvihen hapësirave të gjera ekzistuese në kryqëzim. Në këto raste mund të lindin të paktën tre raste të pa përshtatshme :

- *Lëvizje të pakontrolluara të automjeteve.*
- *Vendkalime të zgjatura të këmbësorëve (kryesisht në zonat urbane).*
- *Zona të asfaltuara të papërdorshme.*

7.4 NENI 49 - Parkimi

1. Baza ligjore ku bazohet numri i vendeve të parkimit të nevojshme për çdo tip aktiviteti përcaktohet në VKM Nr. 686, date 22.11.2017.
2. Përveç sa është parashikuar në pikën 1 të këtij neni, të kësaj rregulloreje, standardi minimal i parkimit do jetë:
   - Për parkimin publik, pavarësisht formës së zgjidhjes së tij, është 6 m²/banor ose 1 vend parkim prej 12 m² për çdo 2 banorë.
   - Për hapësirën e parkimit të dedikuar për objekte me përdorim jo banim, është 12 m²/përdorues dhe llogaritet mbi bazën e fluksit mesatar deri në maksimal 24-orësh të përdoruesve të objektit.
   - Për parkimin privat për objekte banimi, pavarësisht formës së zgjidhjes së tij, është 15 m²/familje ose apartament.

Në të gjitha rastet të parashikohen vendparkime për personat me aftësi të kufizuara.

Parkimi mund të jetë privat ose publik dhe format e zgjidhjes janë në rrugë, në sheshe publike, në sipërfaqe mbi ose nën tokë, në struktura me një ose disa nivele dhe në pjesë të objekteve me përdorime të ndryshme.

Përvec sa parashikohet në V.K.M më sipër, më poshtë po japim dhe disa referenca shtesë lidhur me parkimin:

Aktiviteti	Numri i nevojshëm i vendeve të parkimit
Hotele	>1 vend për çdo 5 dhoma
Aktivitete tregtare	> qendra e qytetit: 1 vend për çdo 100m2 > zona tregtare larg qendrës: 2 vende për çdo 100m^2
Aktivitete dhe Shërbime	>1 vend për çdo 100 m^2 sipërfaqe
Shkollat dhe arsimi:	>1 vend për çdo klasë

Në lidhje me Tabelen e mësipërme, duhet vënë në dukje se:

- Në rast përdorimi të kombinuar, kërkesa totale lidhet në mënyre proporcionale me secilin tip përdorimi.

Kërkesat e dhëna më lart mund të rishikohen për të marrë parasysh objektivin politik për transportin, i cili parashikon uljen e kërkesës për vende parkimi në qytet nëpërmjet përmirësimit të shërbimit të trasnportit publik dhe rritjes së numrit të vendeve të parkimit në periferinë urbane.

7.5 NENI 50 - Transporti publik

Shërbimi i transportit qytetës të udhëtarëve në Bashkinë e Tropojës do të jetë i organizuar nga strukturat përkatëse të saj në përputhje me Ligjin Nr.8308.dt.18.03.1998 "Për Transportet Rrugore", (i ndryshuar), Ligjin Nr.8378.dt.22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", si dhe udhëzimet e tjera të fushës së transportit që në thelb kanë disiplinimin e parametrave tekniko - ekonomik që operatorët duhet të plotësojnë në lidhje me kushtet e kryerjes së shërbimit.

Bashkia e Tropojës ka për synim të rrisë shërbimin e transportit publik. Për këtë qëllim duhet të bëhen disa rregullime në infrastrukturë për të siguruar një shërbim transporti publik të shpeshtë, të shpejtë, të besueshëm dhe konfort, për të cilat duhet të merren këto masa:

- Stacionet e duhet të plotësojnë të gjithë elementët e nevojshëm për t'ju siguruar akses të gjithë përdoruesve si psh: ulja e trotuarëve, vendosja e kabinave, informimi i qytetarëve etj.
- Të përcaktohen korsi të veçanta për autobuzë në rrugët kryesore dhe dytësore.

Mjetet e shërbimit publik autobuzë duhet të konsiderojnë:

- Kondicionimi: 100 % i mjeteve të transportit.

- Mjetet duhet të jenë të pajisura me pajisje të veçanta për invalidët.
- Dyert e autobusëve të kenë të shkruar dukshëm brenda dhe jashtë autobusit hyrjet dhe daljet.
- Në autobusët të jenë caktuar dhe shënuar dukshëm numri i vendeve të ulura dhe numri maksimal i udhëtarëve që mund të transportojnë.
- Të kenë ndriçim të brendshëm të korridoreve, në hyrje dhe dalje si dhe mbi sediljet, të komandueshme, funksionale dhe me sistem mbrojtje elektrike.

7.6 NENI 51 - Lëvzja me Biçikleta

Në lëvizjen me mjete alternative si një element i rëndësishëm për plotësimin e skemës së transportit multimodal është dhe lëvizja me bicikleta. Në të gjitha projektet që do të aplikohen nga Bashkia e Tropojës është e rëndësishme ndjekja e parimit të mëposhtëm në projektim:



Figura 5 Skema e projektimit të rrugës.

Kjo mënyrë projektimi zbatohet në bazë të strategjisë së transportit multimodal në qytetin e Bajram Currit dhe parashikon sistemimin e infrakstrukturës sipas parimit të shpërndarjes së sipërfaqes të rrugës për cdo përdorues duke i dhënë prioritet shërbimit publik, lëvizjes me bicikleta dhe lëvizjes së këmbësorëve. Në vijim po japim disa standarde që duhet të konsiderohen gjatë projektimit të korsive të bicikletave:

- *Korsitë:* Gjerësitë e korsive variojnë duke patur parasysh dimesionet e bicikletës dhe balancës të përshtashme në lidhje me hapësirën e lirë dhe pengesat.
  - *Gjerësia e korsisë së bicikletës duhet të jetë 1.5 deri 1.8 m për një drejtim lëvizje*
  - *Gjerësia e korsisë me dy drejtime (vajtje –ardhje) duhet të jetë minimumi 2.5 m*

Në raste të vecanta për të mundësuar zgjidhjen në mungesë të hapësirës:

- *Një korsi*, për gjatësitë minimale mund të jetë deri 1 m
- *Dy korsi*, për gjatësitë minimale mund të jetë deri 2 m
- *Rrezja e përdorimit* duhet të jetë më e madhe se 5m

Korsitë e bicikletave duhet të ndahen qartësisht nga mënyrat e tjera të lëvizjes me anë të një brezi sigurie i cili ka një minimum prej 0.5m.
Struktura e korsive të bicikletave:

- Rrugë me shtrese betoni të stampuar me ngjyrë të vecantë.
- Rrugë me shtrese asfalti të stampuar me ngjyrë të vecantë.
- Rrugë me pllaka betoni me ngjyrë të vecantë.

Shpejtësia e lëvizjes së bicikletës:

- Çiklistët duhet të lëvizin (pedalojnë) me një shpejtësi prej 20-25 km/orë
- Dhe në korsi me pjerrësi prej 5% shpejtësia duhet të arrijë deri në 40 km/orë

Sinjalistika e nevojshme dhe stacionet e qëndrimit:

- Për të drejtuar fluksin e çiklistëvë do të përdoret:
  - *Sinjalikë horizontale e verdhë.*
  - *Sinjalikë vertikale.*
  - *Stacione qëndrimi komfort.*

8 RREGULLA, NORMA DHE STANDARDE NË LIDHJE ME MJEDISIN NATYROR, KULTUROR DHE URBAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

8.1 NENI 52 - Udhëzime dhe masa zbutëse për ndikimin në mjedis dhe peizazh

1. Për të siguruar ruajtjen e peizazheve të jashtëzakonshme, zonave të peizazheve me karakteristika të dallueshme në nivel lokal e kombëtar dhe një imazh të cilësisë së lartë të peizazhit, duhet të ndiqen udhëzimet e mëposhtme:

   a. Ndërhyrjet e infrastrukturës së re nuk duhet të integrohen në zonat e veçanta të peizazhit apo peizazheve me karakteristika të dallueshme në nivel lokal e kombëtar;

   b. Në integrimin hapësinor të projekteve specifike duhet të kërkohen vende jashtë zonave me peizazhe të veçantë apo zonave me peizazhe me karakteristika të dallueshme në nivel lokal e kombëtar, zonave të mbrojtura dhe të zonave të Natura 2000.

2. Duhet të zbatohen masat e duhura teknike për të siguruar një imazh të cilësisë së lartë të peizazhit dhe krijimin dhe përmirësimin e korridoreve ekologjike , veçanërisht në rastin e aktiviteteve në njësitë e ruajtura apo të pasura kulturore të natyrës;

   - Me integrimin e infrastrukturës së parashikuar në mjedis, përmirësimet brenda korridoreve apo strukturave ekzistuese kanë përparësi mbi ndërtimet e reja.

3. Në integrimin hapësinor të infrastrukturës së parashikuar, duhet të shmanget ndërhyrja e projekteve në zonat me karakteristika të çmuara natyrore.

4. Gjatë zgjedhjes dhe projektimit të detyrave të propozuara, konsideratë duhet t'i jepet shmangies së ndikimeve kudo që të jetë e mundur. Në këtë kuadër, alternativa përfundimtare e miratuar për çdo projekt duhet të zgjidhet e tillë që të minimizojë ndikimin në karakteristikat e banimit, karakteristikat topografike, pemët dhe pyjet.

5. Në çdo rast në zonat malore dhe afërsi të sipërfaqeve ujore hapësira që kërkon zënien e tokës do të ruhet në minimum, me qëllim që të shmanget prerja e panevojshme e pemëve.

6. Prioritetet për çdo ndërhyrje përmirësimi mjedisor, ripyllëzim, konsolidim, ndërtim brezave mbrojtës do të përcaktohen në funksion të përmirësimit të korridoreve ekologjike; kjo konsiston në rivendosjen e lidhjeve ekologjike midis parqeve të shumta dhe zonave të mbrojtura, brenda kontekstit të një procesi më të gjerë të rrjetit ekologjik rajonal duke filluar me hapësirat e mëdha të gjelbra dhe blu

7. Shfrytëzimi i pyjeve duhet të bëhet në përputhje me LIGJ Nr.9385, datë 4.5.2005 (ndryshuar me LIGJ48/2016, datë 5.5.2016) dhe në ç'do rast duhet të sigurojë ripërtëritjen e fondit pyjor nëpërmjet planeve të mbarështimit apo krijimit të fidanishteve.

8.2 NENI 53 - Rregulla për trashëgiminë kulturore

1. Plani i përgjithshëm vendor trajton dhe përditësimin e kornizave ligjore për mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore, bazuar në ligjin Nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar me ligjin 9882, datë 28.02.2008), për objektet me status Monument Kulture, të kategorive I ose II si dhe zonat e mbrojtura të tyre. Për objektet monument kulture të cilat nuk kanë zonë mbrojtëse, është ky plan që përcakton zonat mbrojtëse detyruese, në respektim të VKM Nr. 686, date 22.11.2017, referuar hartës së "Planit të mbrojtjes të pasurisë kulturore", pjesë e dokumentit të këtij plani.

2. Në respektim të pikës 1 të këtij neni, si dhe të përcaktimeve të këtij plani për objekte me vlera kulturore, në hartën e "Planit të mbrojtjes të pasurisë kulturore", lejohen ndërhyrje për ristrukturim për këto ndërtesa, vetëm pas konfirmimit nga Instituti i Monumenteve të Kulturës pasi të jetë vlerësuar që ndërhyrja e propozuar nuk cënon vlerat historike të këtyre strukturave. Në respektim të kushteve të kësaj pike dhe përcaktimeve të këtij plani, në të gjitha rastet, mënyra e ndërhyrjes në territor për këto struktura është konservim dhe/ose ristrukturim.

8.3 NENI 54 - Rregulla për trashëgiminë natyrore

1. Territori administrativ i Bashkisë Tropojë përmban zona të mbrojtura natyrore të cilat plani i ripërkufizon në respektim të kuadrit ligjor në fuqi për zonat e mbrojtura natyrore. Në të gjitha monumentet e natyrës të paraqitura në hartën e "Planit të mbrojtjes së pasurisë natyrore", nuk lejohen ndërhyrje që cënojnë integritetin natyror të tyre.

2. Në respektim të pikës 1 të këtij neni, si dhe të propozimeve për zona me vlera të veçanta natyrore sipas përcaktimeve të këtij plani në hartën e "Planit të mbrojtjes të pasurisë natyrore", Bashkia e Tropojës ka detyrimin e saktësimit të përmasave gjeometrike në raport me shtrirjen gjeografike të këtyre territoreve si dhe të zonave përkatëse mbrojtëse, jo më vonë se 1 vit pas miratimit të këtij plani të përgjithshëm vendor.

8.4 NENI 55 - Rregulla për sistemin ujor

1. Të gjitha sipërfaqet ujore, të identifikuara si të tilla sipas përkufizimeve ligjore të ligjit të planifikimit të territorit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", kanë të përcaktuar nga ky plan i përgjithshëm vendor zonën mbrojtëse (buferike) dhe vijën blu, sipas hartës

së "Planit të mbrojtjes së burimeve ujore" pjesë e dokumentit të planit, në respektim të përcaktimeve ligjore në fuqi.

8.5 NENI 56 - Rregulla për projektimin në respektim të nevojave për personat me aftësi të kufizuara

1. Në të gjitha strukturat publike apo dhe ato private për përdorim më të gjerë se një-familjar, gjatë procesit të projektimit dhe të zbatimit, do të respektohen kushtet ligjore për personat me aftësi të kufizuara, sipas standarddeve ligjore në respektim të ligjit nr. 93/2014, datë 09.11.2014, "Për përfshirjen Sociale dhe Aksesueshmërine e Personave me Aftësi të Kufizuara" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij si dhe VKM Nr. 1503 datë 19.11.2008, për miratimin e rregullores "Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftesi të kufizuar". Të respektohen standardet e përcaktuara në Shtojcën 2, përveç rasteve kur këto normativa rregullohen me akte të veçanta ligjore.
2. Për stacionet intermodale vlejnë direktivat e pikës 1 neni 28 i VKM Nr. 1503 datë 19.11.2008.

9 DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA KOMBETARE E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT
TIRANE
SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT
TIRANE
SEKRETARIA

9.1 NENI 57 - Kushte të përgjithshme

1. Territori administrativ i Bashkisë Tropojë, është ripërkufizuar si pasojë e ndryshimeve territoriale. Skema e rrjetit rrugor të propozuar është ridimensionuar duke reflektuar një filozofi ndërlidhje gjithpërfshirëse e cila i kalon dimensionet gjeografike të kufijve administrativ të bashkive të vjetra, si dhe duke racionalizuar realizueshmërinë e tyre duke rivlerësuar në maksimum rrjetet rrugore dhe korridoret e lira ekzistuese, të mundshme për rizhvillim dhe ridimensionim.

2. Ky plan dhe kjo rregullore përcaktojnë kushtin e realizimit të projekteve teknike të të gjitha rrjeteve të rrugëve kryesore dhe dytësore të bashkisë, brenda një periudhe kohore prej 4 vitesh nga miratimi i këtij plani.

3. Kushtet zhvillimore që përfshijnë intensitetin e ndërtimit, sipërfaqet e gjelbra, parkimet dhe koeficientët e shfrytëzimit të tokës për ndërtim për çdo njësi strukturore të përcaktuara nga ky plan në këtë rregullore vendore, pjesë të pasaportave të njësive, janë kushtëzuese. Të dhënat parametrike që rrjedhin nga përballja e kushteve me standardet kombëtare të planifikimit janë orientuese dhe statistikore.

4. Me miratimin e këtij plani, autoritetet vendore të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit kanë detyrimin e respektimit të kushteve të përcaktuara nga ky plan dhe kjo rregullore zhvillimi.

9.2 NENI 58 - Detyrimi i zbatimit të rregullores

1. Shkeljet e rregullave të përcaktuara në këtë rregullore përbëjnë kundërvajtje dhe dënohen në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

2. Bashkia e Tropojës është autoriteti që zgjidh çështjet e menaxhimit të zhvillimit të territorit për zbatimin e këtij plani, të cilat nuk gjejnë zgjidhje në këtë rregullore, përmes zbatimit të legjislacionit në fuqi, me miratim të institucioneve përkatëse sipas rastit.

3. Zbatimi i rregullores është i detyrueshëm për të gjithë personat fizikë e juridikë që ushtrojnë aktivitetin e tyre, kanë pronësi dhe/ose banojnë në territorin e Bashkisë Tropojë, sipas sipërfaqes dhe kufirit të përcaktuar nga ky plan i përgjithshëm vendor.

9.3 NENI 59 - Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore dhe ky plan i përgjithshëm vendor për territorin e ri administrativ të Bashkisë Tropojë, nuk kanë efekt paraveprues dhe hyjnë në fuqi me miratimin e tij nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

9.4 NENI 60 - Referencat ligjore

1. Në hartimin e kësaj rregulloreje janë mbajtur parasysh përcaktimet e ligjeve të poshtë-shënuara si dhe të gjithë akteve nënligjore të dala në zbatim të tyre.

1	Ligj nr.44/2015, datë 30.04.2015	Kodi i procedurave administrative
2	Ligj nr.139/2015, datë 17.12.2015	Për vetqeverisjen vendore, (i ndryshuar)
3	Ligj nr.9632, datë 30.10.2006	Për sistemin e taksave vendore, (i ndryshuar)
4	Ligj nr.8561, datë 22.12.1999	Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik
5	Ligj nr.7850, datë 29.07.1994	Kodi civil i Republikës së Shqipërisë, (i ndryshuar)
6	Ligj, Nr.33/2012, Dt.Aktit: 21.03.2012	Për rregjistrimin e pasurive të paluajtshme, (i ndryshuar)
7	Ligj nr.8743, datë 22.02.2001	Për pronat e paluajtshme të shtetit, (i ndryshuar)
8	Ligj nr.8744, datë 22.02.2001	Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore,(i ndryshuar)
9	Ligj nr.8398, date 09.03.1998	Për kompensimin e ish-pronarëve të tokës bujqësore, jobujqësore dhe të trojeve të zëna, që ndodhen në territorin e Tropojës
10	Ligj nr.133/2015, datë 05.12.2015	Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave
11	Ligj nr.9948, datë 07.07.2008	Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore (i ndryshuar)
12	Ligj nr.9482, datë 03.04.2006	Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e strukturave pa leje, (i ndryshuar)
13	Ligj nr.8402, datë 10.09.1998	Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit,(i ndryshuar)
14	Ligj nr.9780, datë 16.07.2007	Për inspektimin e ndërtimit (i ndryshuar)

15	Ligj nr.9290, datë 07.10.2004	Për produktet e ndërtimit, (i ndryshuar)
16	Ligj nr.152/2015, datë 21.12.2015	Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin
17	Ligj nr.8734, datë 01.02.2001	Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike, (i ndryshuar)
18	Ligj nr.32/2016 datë 24.03.2016	Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion,(i ndryshuar)
19	Ligj nr.6/2015, datë 12.02.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"
20	Ligj nr.9232, datë 13.05.2004	Për programet sociale për strehimin e banorëve të nën-njësi strukturore urbane, (i ndryshuar)
21	Ligji nr.8308, datë 18.03.1998	Për transportet rrugore, (i ndryshuar)
22	Ligji nr.8378, datë 22.07.1998	Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë, (i ndryshuar)
23	Ligji nr.9918, datë 19.05.2008	Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë (i ndryshuar)
24	Ligj nr.125/2013, datë 25.04.2013	Për koncesionet dhe partneritetin publik – privat (i ndryshuar)
25	Ligj nr.9869, datë 04.02.2008	Për huamarrjen e qeverisjes vendore (i ndryshuar)
26	Ligji nr.8527, datë 23.09.1999	Për privatizimin e hidrocentraleve vendore, (i ndryshuar)
27	Ligji nr.9789, datë 19.07.2007	Për krijimin dhe funksionimin e nën-njësive strukturore ekonomike
28	Ligj nr.9817, datë 22.10.2007	Për bujqësinë dhe zhvillimin rural
29	Ligj nr.111/2012, datë 15.11.2012	Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore
30	Ligj nr.8102, datë 28.03.1996	Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura, (i ndryshuar)
31	Ligj nr.8681, datë 02.11.2001	Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave (i ndryshuar)
32	Ligj nr.24/2017, datë 09.03.2017	Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit

33	Ligj nr.10431, datë 09.06.2011	Për mbrojtjen e mjedisit (i ndryshuar)
34	Ligj nr.8672, datë 26.10.2000	Për Ratifikimin e "Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit"
35	Ligj nr10440, datë 07.07.2011	Për vlerësimin e ndikimit në mjedis (i ndryshuar)
36	Ligj 10448 date 14.07.2011	Për lejet mjedisore (i ndryshuar)
37	Ligj nr.9424, datë 06.10.2005	Për ratifikimin e "Protokollit të vlerësimit strategjik mjedisor"
38	Ligj nr.81/2017, datë 18.05.2017	Për zonat e mbrojtura
39	Ligj nr.10/463, datë 22.09.2011	Për menaxhimin e integruar të mbetjeve (i ndryshuar)
40	Ligj nr.8094, datë 21.03.1996	Për largimin publik të mbeturinave
41	Ligj nr.162/2014, datë 04.12.2014	Për mbrojtjen e cilësisë të ajrit në mjedis
42	Ligj nr.9774, datë 12.07.2007	Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis (i ndryshuar)
43	Ligj nr.9048, datë 07.04.2003	Për trashëgiminë kulturore, (i ndryshuar)
44	Ligj nr.9386, datë 04.05.2005	Për muzetë
45	Ligj nr.91/2015, datë 23.07.2015	Për turizmin
46	Ligj 10186 datë 05.11.2009	Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në nën-njësitë strukturore me përparësi turizmin.
47	Ligj nr.7893, datë 22.12.1994	Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik, (i ndryshuar)
48	Ligj nr.69/2012, datë 21.06.2012	Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë
49	Ligj nr.15/2017, datë 16.02.2017	Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë

50	Ligj nr.80/2015, datë 22.07.2015	Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, (i ndryshuar)
51	Ligj nr.9136, datë 11.09.2003	Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, (i ndryshuar)
52	Ligj nr.3766, datë 17.12.1963	Mbi shërbimin shëndetësor dhe dhënien falas të ndihmës mjekësore të shtetit, (i ndryshuar)
53	Ligj nr.62/2013, datë 14.11.2013	Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë
54	Ligj nr.107/2014, datë 31.07.2014	Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit (i ndryshuar)
55	Ligj nr. 93/2014, datë 09.11.2014	Për përfshirjen Sociale dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara

10 **SHTOJCA 1**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGENCIA KOMBËTARE E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

	Sip. përgjithshme	Organizimi planimetrik	Elemente të fasadës
Një katëshe			
			
Një kat e gjysmë			
			
Dy kate			
			
Kullë			 
			 

Volumetri	Materialet	Ndërtesa dytësore
	- Mure me gurë të çrregullt, të lidhura me llaç gëlqereje - Çati druri me mbulesë druri ose tjegulla. - Dritare/ dyer prej druri. - Shkallë guri para portës.	
	- Mure me gurë të çrregullt, të lidhura me llaç gëlqereje. - Çati druri me mbulesë druri ose tjegulla. - Dritare/ dyer prej druri. - Shkallë guri para portës.	
	- Mure me gurë të çrregullt, të lidhura me llaç gëlqereje. - Çati druri me mbulesë druri ose tjegulla. - Dritare/ dyer prej druri. - Pa shkallë para portës.	
	- Mure me gurë të çrregullt, të lidhura me llaç gëlqereje. - Çati druri me mbulesë druri ose tjegulla. - Dritare/ dyer prej druri. - Pa shkallë para portës.	
	- Mure me gurë të çrregullt, të lidhura me llaç gëlqereje. - Çati druri me mbulesë druri ose tjegulla. - Trarë dhe ballkone druri - Dritare/ dyer prej druri. - Pa shkallë para portës.	
	- Mure me gurë të çrregullt, të lidhura me llaç gëlqereje. - Çati druri me mbulesë druri ose tjegulla. - Trarë dhe ballkone druri - Dritare/ dyer prej druri. - Pa shkallë para portës.	
	- Mure me gurë të çrregullt, të lidhura me llaç gëlqereje. - Çati druri me mbulesë druri ose tjegulla. - Dritare/ dyer prej druri. - Shkallë druri/ guri para portës.	

Raportet në plan



Elementet e çatisë



Çarjet në fasadë

Dyer dhe dritare



Ballkone



Rrethim



Shkallë të jashtme



Elementët e gjetur në territor

Pas një analize të objekteve të gjetura në territor, janë evidentuar një seri elementesh arkitektonike të zbatuara gjatë kohës, qysh prej fillimit të konsolidimit të tipologjisë së banimit në këto zona.
Nisur nga këto gjetje dhe elementë, dhe bazuar në ligjet përkatëse për kriteret e projektimit, janë përshtatur dhe jepen sugjerime për aplikimin e tyre në ndërtimet e reja. Kjo nuk është detyruese, por në trajtë rekomandimesh për të ruajtur, perforcuar dhe për të çuar më tej karakterin ndërtimor të rajonit.





Elemente dhe sugjerime për ballkonet



Raporti mes planit dhe çarjeve në fasadë







11 **SHTOJCA 2**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA



Fig.1 Sipërfaqe relievore.



Fig.2 Vendkalimi i këmbësorëve në vendin me lartësi më të vogël të trotuari.

Përmbledhje e rregullores "Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftesi të kufizuar" miratuar me VENDIM Nr.1503, datë 19.11.2008

Neni 5 - Zonat për zhvillim

Zonat e destinuara për zhvillim publik për të cilat kryet studimi i fisibilitetetit-paraprojekti, zgjidhen duke preferuar, ato që sigurojnë projektimin e ndërtesave dhe hapësirave pa barriera arkitektonike.

Neni 6 - Hapësirat për këmbësorët

Projektet që i përkasin hapësirave publike dhe veprave të urbanizimit me qëllimin e vetëm për t'u përdorur nga këmbësorët, duhet të parashikojnë të paktën një rrugë hyrëse që të lejojë përdorimin e impianteve ngritëse aty ku është e nevojshme, përdorimin e shërbimeve sociale dhe shfrytëzimin e ambienteve nga personat me aftësi të kufizuar. Rrugët në hapësirat e jashtme, që të çojnë tek hyrja e ndërtesave, duhet të paktën një prej tyre të parashikohet me karakteristikat që lejonë lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara ose paaftësi levizëse dhe t'u garantojë atyre përdorimin e pajisjeve, të parkimeve dhe të shërbimeve të vendosura jashtë ndërtesës.
